

**Dy fjalë  
për misionet  
e vëzhgimit  
dhe për  
metodologjinë  
e tyre**

**K**omiteti Shqiptar i Helsinkit, themeluar më 19 dhjetor 1990, është e para organizatë joqeveritare që ka për mision mbrojtjen, edukimin dhe sensibilizimin e opinionit publik dhe të organeve shtetërore për një respektim më të mirë të të drejtave dhe lirive themelore të individit në vend. Një nga fushat me përparësi të tij ka qenë dhe mbetet respektimi i të drejtave të të paraburgosurve dhe të të dënuarve me burgim dhe trajtimi i tyre sipas të gjitha standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit përkatës në fuqi. Kështu, gjatë muajve shtator – dhjetor 2004, në kuadër të projektit “Reforma në burgje dhe roli i shoqërisë civile në Shqipëri”, KShH-ja ka ndërmarrë një raund misionesh vëzhgimi në një numër të konsiderueshëm vendesh paraburgimi dhe pothuajse në të gjitha institucionet e riedukimit.

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Qëllimi kryesor ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave të personave të dënuar dhe të paraburgosur, vëzhgimi i zbatimit të ligjit, identifikimi i shkeljeve të të drejtave si dhe i problemeve ligjore që çojnë në shkelje të të drejtave.

Vëzhgimet janë bazuar në kërkesat e legjislacionit shqiptar, si: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Kodi penal; Kodi i procedurës penale; ligji nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë"; ligji nr. 8328, datë 16.4.1988, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim"; ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale"; vendimi i Këshillit të Ministrave nr.327, datë 15.5.2003; Rregullorja për policinë e burgjeve; Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit, nr.3750/2, datë 23.7.2003; Rregullorja e përgjithshme e burgjeve, nr. 63, datë 9.3.2000; urdhri i përbashkët i ministrit të Rendit dhe i ministrit të Drejtësisë, nr.3750/1, datë10.7.2003, si dhe konventa të ndryshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe për të drejtat e të paraburgosurve dhe të dënuarve në veçanti.

Vëzhgimi u krye në 16 komisariate policie që kanë dhoma paraburgimi<sup>1</sup>, në institucionin e paraburgimit nr. 313, Tiranë, në burgjet nr. 325 dhe nr. 302 në Tiranë, në burgun e Krujës, të Tepelenës, Peqinit, Rogozhinës, Vaqarit, si dhe në spitalin e burgut.

Vëzhgimet u realizuan nga vëzhgues të KShH-së, të trajnuar paraprakisht për ligjin dhe metodologjinë, specialistë në fusha të tilla, si: drejtësi, shkenca sociale dhe mjekësi si edhe nga korrespondentët e KShH-së.

Për sa i përket metodologjisë, janë përdorur pyetësorë, janë organizuar takime të lira dhe të drejtpërdrejta me të paraburgosur dhe të dënuar, është vëzhguar dokumentacioni, është bërë ballafaqimi i këtyre gjetjeve me ligjin si dhe janë organizuar takime me drejtues të institucioneve të vuajtjes së dënimit, të dhomave të paraburgimit, të komisariateve të policisë, me shefat e sektorëve të ndryshëm të administratës së këtyre institucioneve etj. Për të verifikuar shqetësimet e ngritura janë takuar me avokatë dhe drejtues të prokurorive dhe të gjykatave të rretheve të vëzhguara.

---

<sup>1</sup> Përkatësisht, në rrethet Berat, Elbasan, Vlorë, Tepelenë, Korçë, Pogradec, Durrës, Krujë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Fier, Gjirokastrë, Krujë dhe Mat.

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Për rastet më flagrante të shkeljeve të të drejtave të personave të paraburgosur dhe të dënuar të konstatuara gjatë vëzhgimeve, KShH-ja ka vënë në dijeni organet kompetente shtetërore ose ka dalë në media përmes deklaratave për shtyp.

KShH-ja gjen rastin të falënderojë Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Ministrinë e Rendit Publik, të cilat i krijuan të gjitha kushtet dhe mundësitë për të realizuar misionet e vëzhgimit. Gjithashtu, vlerëson faktin që Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në bazë të ndërhyrjeve dhe të kërkesave të KShH-së, herë pas here kanë marrë masa për të rivendosur të drejtat e shkelura.

## Përmbajtja

Dy fjalë për misionet e vëzhgimit dhe për metodologjinë e tyre 5

### **1 RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PARABURGOSUR NË DHOMAT E PARABURGIMIT** 9

---

1.1	Transferimi i sistemit të paraburgimit	9
1.2	Zbatimi i ligjit nr. 8328, datë 16.4.1988, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” ndaj personave të paraburgosur	10
1.3	Infrastruktura dhe kushtet fizike të vendeve të paraburgimit	11
1.4	Kapaciteti i dhomave të paraburgimit	15
1.5	Dhomat e ajrimit dhe ajrosja	15
1.6	Mbajtja e të dënuarve me vendim të formës së prerë	16
1.7	Informimi i të drejtave në çastin e ndalimit ose të arrestimit	17
1.8	Shërbimi shëndetësor	17
1.9	E drejta e informacionit, e ushtrimit të riteve fetare dhe e aktiviteteve zbavitëse	19
1.10	Puna edukative me personat e arrestuar në vendet e paraburgimit	20
1.11	Përdorimi i dhunës	21
1.12	Takimet me familjarët	21
1.13	Trajtimi i personave të mitur të arrestuar	22
1.14	Trajtimi i femrave të paraburgosura	23

### **2 RESPEKTIMI I TË DREJTAVE NË INSTITUCIONET E VUAJTJES SE DENIMIT** 25

---

2.1	Infrastruktura dhe kushtet fizike të institucioneve të vuajtjes së dënimit	25
-----	---	----

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

2.2	Mjediset e qëndrimit dhe të fjetjes	26
2.3	Veshja dhe pajisjet	27
2.4	Higjiena vetjake dhe e mjedisit	28
2.5	Ushqimi	28
2.6	Koha e ajrimit	29
2.7	Shërbimi shëndetësor	30
2.8	Pranimi dhe trajtimi i të dënuarve në institucionet e vuajtjes së dënimit	33
2.9	Trajtimi i të dënuarve	33
2.10	Punësimi i të dënuarve	34
2.11	Arsimimi i të dënuarve	35
2.12	Veprimtaritë kulturore, çlodhëse e sportive	37
2.13	E drejta e besimit dhe e ushtrimit të riteve fetare	37
2.14	Lidhjet e të dënuarve me familjen	38
2.15	Përdorimi i dhunës	40
2.16	Trajtimi i ankesave të të dënuarve	40
2.17	Trajtimi i të miturve	41
2.18	Trajtimi i grave të dënuara	43
2.19	Trajtimi i të sëmurëve	44
2.20	Probleme të tjera	46

## **3** SUGJERIME 47

---

Sugjerime për përmirësimin e situatës në vendet e paraburgimit	47
Sugjerime për përmirësimin e situatës në institucionet e vuajtjes së dënimit	50

## **4** SHTOJCË 55

---

# RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PARABURGOSUR NË DHOMAT E PARABURGIMIT

# 1

## 1.1 Transferimi i sistemit të paraburgimit

Në nenin 6 të ligjit nr. 8678, datë 14.V.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, thuhet: “Ministria e Drejtësisë drejton sistemin e paraburgimit...”, ndërsa në nenin 16 të po këtij ligji thuhet: “Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, ndjek dhe realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit...”. Gjithashtu, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 327, datë 15.III.2003, “Për kalimin e sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë”, dhomat e paraburgimit kalojnë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Në vijimësi të këtij vendimi, Ministria e Drejtësisë dhe ajo e Rendit Publik nënshkruan një marrëveshje për të bërë kalimin e sistemit të paraburgimit sipas një plani i cili duhet të fillonte në gusht të vitit 2003 dhe të përfundonte në prill të vitit 2004.

Deri në dhjetor të vitit 2004, nën varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve kanë kaluar vetëm dhomat e paraburgimit pranë komisarariatit të rrethit të Vlorës dhe të Shkodrës. Nga vëzhgimet e

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

kryera rezultoi se, në praktikë, kalimi i dhomave të paraburgimit nën varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve ka hasur shumë probleme dhe vështirësi.

Lidhur me këtë problem, KShH-ja i ka sugjeruar Ministrisë së Drejtësisë të marrë masat konkrete për zgjidhjen e kësaj çështjeje në përputhje me ligjin nr. 8678, datë 14.V.2001, dhe vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 327, datë 15.III.2003.

### **1.2 Zbatimi i ligjit nr. 8328, datë 16.4.1988, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” ndaj personave të paraburgosur**

Me përjashtim të administratës së paraburgimit në Vlorë dhe të administratës së institucionit nr. 313 në Tiranë, administratat e vendeve të paraburgimit zbatojnë rregulloren e Ministrisë së Rendit, nr. 1075, datë 15.9.1999, “Për sigurimin dhe trajtimin e të paraburgosurve”, në një kohë kur Ministria e Drejtësisë ka miratuar rregulloren nr.3750/2, datë 23.7.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit”. Sipas nenit 55 të kësaj rregulloreje, thuhet: “Kjo rregullore është e vlefshme për të gjitha dhomat e paraburgimit që ndodhen brenda komisariatit. Rregulloret e tjera të paraburgimit, me miratimin e kësaj rregulloreje, shfuqizohen”.

Edhe pse KShH-ja u ka tërhequr disa herë vëmendjen autoriteteve përkatëse shtetërore, duke theksuar se zbatimi ende i rregullores të vitit 1999 është në kundërshtim me ligjin, gjendja vazhdon të jetë si më parë.

KShH-ja i rekomandon Ministrisë së Rendit Publik të shfuqizojë rregulloren e vitit 1999 dhe në të gjitha vendet e paraburgimit të zbatojë rregulloren e vitit 2003 në mbështetje të nenit 75<sup>2</sup> të ligjit nr. 8328, datë 16.4.1988, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” (këtëj e tutje ligji).

---

<sup>2</sup> Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj të arrestuarve dhe të ndaluarve, duke respektuar kufizimet e vendosura për ta me ligje të tjera.

### 1.3 Infrastruktura dhe kushtet fizike të vendeve të paraburgimit

Pjesa më e madhe e komisariateve të vëzhguara kishin infrastrukturë të vjetër që nuk mundësonte as funksionimin minimal të vendeve të paraburgimit. Korridoret dhe zyrat ishin me lagështirë dhe të parikonstruktura, në disa komisariate mungonte sistemi i ngrohjes, mungonin pajisjet më elementare të punës, si: raftet, dosjet, kompjuterat, mjetet kancelarike ose ato ishin të amortizuara.

Në komisariatet e Elbasanit, Beratit dhe Durrësit, kushtet e punës për administratën e vendeve të paraburgimit ishin më të mira.

Në pjesën më të madhe të komisariateve të vëzhguara, gjendja e mjediseve të paraburgimit nuk plotësonte as kushtet minimale për një jetë normale të personave që mbahen në to si edhe për stafin e këtyre institucioneve. Këto mjedise ishin krejtësisht të papërshtatshme: dritaret me xhama të thyer e të zëvendësuar me kompensatë, dyert të prishura, muret të palyera e me lagështirë, pajisjet shumë të vjetruara, ishin pa sistem ngrohjeje, pa kasaforta e pa dollapë për mbajtjen e dosjeve të personave të paraburgosur, regjistrave etj. Edhe mjediset për personelin ishin të pamjaftueshme, p.sh.: në komisariatit e Shkodrës, në dhomën që përdornin për takimet e të paraburgosurve përgjegjësi i dhomave të paraburgimit mbante dokumentacionin e tyre; në Krujë, Fier, Lezhë, në zyrat e personelit të vendeve të paraburgimit mbaheshin thasë me bukë, tasa metalikë, batanije, shapka etj.; në dhomat e paraburgimit të Vlorës, i vetmi që ka kaluar në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, mungonin dhomat e punës së prokurorit dhe të oficerit të policisë gjyqësore, duke shkaktuar vështirësi në punën e tyre.

Në shumicën e komisariateve të vëzhguara, dhomat e paraburgimit ishin të vogla dhe kushtet infrastrukturore të vështira. Në përgjithësi, ato ishin të nëndheshme, të parikonstruktura, të palyera, të pashtruara, me korridore të ngushta, me mure shumë të vjetra dhe me lagështirë si dhe pa sistem ngrohjeje. Në kushtet ku të paraburgosurit flinin pothuajse në tokë, mungesa e ngrohjes e vështirësonte situatën sidomos në dimër. Në të gjitha dhomat e paraburgimit të vëzhguara mungonin pajisjet më elementare, si krevatet, dollapët për mbajtjen e ushqimeve, komodinat etj., gjë që vjen në kundërshtim me nenin 12



---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit”, nr.3750/2, dt.23.7.2003<sup>3</sup>.

Ndriçimi natyror ishte i pamjaftueshëm dhe kishte shumë ndërprerje të energjisë elektrike. Në komisariatit e Lezhës dhe të Matit, në ditë me reshje, dhomat e paraburgimit shpesh përmbytshin. Në këto raste grupi i gatshëm ishte i detyruar t'i transportonte të paraburgosurit në mjediset e prokurorisë së rrethit. Të paraburgosurit qëndronin në dhoma mbi kapacitetin e përcaktuar në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit” nr.3750/2, dt.23.7.2003.

Grupi i monitorimit, që ishte i pranishëm në paraburgimin e Vlorës, në një ditë me shi, raportoi se në dhomat e paraburgimit kishin vendosur tasa dhe plastmasa për të penguar rrjedhjen e shiut brenda dhomave. Lagështira e mureve në këto dhoma ishte shumë e madhe aq sa kishte rënë suvaja.

Në të gjitha dhomat e paraburgimit të vëzhguara, me përjashtim të paraburgimit nr. 313 në Tiranë, flinin mbi dyshekë të hollë që përdoreshin prej vitesh, ose mbi batanije. Në komisariatit e Kukësit dhe të Lezhës mungonin edhe batanijet.

Në komisariatit e Durrësit, për shkak të mungesës së hapësirës së nevojshme, vazhdonte ende praktika e të fjeturit me turne. Kushtet jonormale të jetesës kanë pasoja të rënda shëndetësore dhe psikologjike mbi personat e paraburgosur.

Si përfundim, mund të themi se infrastruktura e dhomave të paraburgimit nuk përmbushte parametrat e përcaktuar në rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit” nr.3750/2, datë 23.7.2003. Konkretisht, ajo vjen në kundërshtim me nenin 11, “Strehimi”, ku strehimi bëhet sipas nenit 21 të Rregullores së përgjithshme të burgjeve<sup>4</sup> si edhe me nenin 12 në po të njëjtën rregullore.

---

<sup>3</sup> “Çdo të paraburgosuri i sigurohen shtresat dhe mbulesat e shtratit në përputhje me normat dhe kushtet atmosferike. Të paraburgosurit kompletohen me dyshekë, jastëkë si dhe një batanije për stinën e verës dhe tri batanije për stinën e dimrit. Kur kushtet klimaterike pësojnë ndryshime të theksuara, bëhet shtesë në kompletin e fjetjes”.

<sup>4</sup> Ky nen thotë: “Në strehimin e të dënuarve do të mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo burgju, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9m<sup>3</sup> dhe sipërfaqja e banimit jo më pak se 4m<sup>2</sup> për çdo të dënuar. Dritaret duhet të jenë në madhësi të mjaftueshme për t'u dhënë mundësinë të dënuarve ndër të tjera për të lexuar ose për të punuar me dritë natyrale në kushte normale. Ato

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Edhe kushtet higjieno-sanitare në dhomat e paraburgimit ishin të rënda dhe linin shumë për të dëshiruar. Në komisariatet e Fierit, Krujës, Korçës, Pogradecit, Shkodrës, Durrësit, në dhoma mbizotëronte erë mjaft e rëndë. Në disa komisariate, si atë të Shkodrës dhe të Beratit, jashtëqitjet e brejtësve i gjeje edhe në korridorre, në raftet ku mbahej ushqimi.

Në disa vende paraburgimi, si të Gjirokastrës, Beratit, Tepelenës, infrastruktura dhe kushte higjienike ishin më të mira.

Krahas infrastrukturës së vjetër, mungesës së fondeve për mirëmbajtjen e dhomave të paraburgimit, ndikonte edhe orari i kufizuar për të paraburgosurit për të kryer nevojat e tyre personale. Zbatimi i rregullores nr.1075 të Ministrisë së Rendit Publik<sup>5</sup> kufizonte kohën e kryerjes së nevojave personale; nga ora 22.00 deri në orën 6.30 të mëngjesit nuk lejohej hapja e dymve të dhomave, duke i detyruar të paraburgosurit t'i kryenin nevojat e tyre personale brenda dhomës në kova të veçanta. Ky shqetësim u ngrit pothuajse nga të gjithë të paraburgosurit e kontaktuar nga KShH-ja. Në disa komisariate të përmendura më sipër ekzistonte një banjë e vetme për të gjithë të paraburgosurit. Në institucionin e paraburgimit nr. 313 numri i tualeteve ishte i vogël.

Megjithëse personeli i vendeve të paraburgimit ishte përpjekur ta zbuste këtë problem, mbipopullimi i dhomave të paraburgimit e vështirësonte zgjidhjen e kësaj situatë.

Në kushtet higjieno-sanitare të vendeve të paraburgimit, në komisariatet e Tepelenës, Vlorës, Korçës, Matit, Shkodrës etj., ndikonte edhe mbajtja e ushqimeve nëpër qese plastike, në tokë, pasi nuk kishte raftet ose dollapë për ruajtjen e ushqimeve. Për krijimin e hapësirave frigoriferike as që bëhej fjalë.

Ajri rëndohej edhe për shkak të sipërfaqes së vogël të dhomave, mbipopullimit të krijuar dhe dritareve të vogla, të mbuluara me hekura dhe me rretë hekuri të cilat, për rrjedhojë, nuk lejonin qarkullimin e ajrit.

---

duhet të lejojnë hyrjen e ajrit të freskët, përveç rastit kur ka një sistem tjetër të përshtatshëm ajrimi. Drita artificiale duhet të plotësojë standardet e njohura teknike...”

<sup>5</sup> Kapitulli V “Regjimi dhe jetesa në dhomat e paraburgimit”, pika 2 thotë: “Të paraburgosurit nxirren për nevoja personale 3 herë në ditë, midis orëve 6.30-20.00, në raste të veçanta kur shihet e nevojshme mund të nxirren edhe jashtë këtij orari”.

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Për sa i takon higjienës personale të të paraburgosurve mungonin kushtet optimale për një higjienë vetjake. Në disa komisarate, batanijet që shërbenin për mbulesë, shpesh nuk ishin të pastra dhe një pjesë e tyre ishin siguruar nga familjarët. Mungesa e dusheve dhe e ujit të rrjedhshëm bënte që të paraburgosurit ndonjëherë të laheshin me ujë të ftohtë. Në disa komisarate të paraburgosurit laheshin 1 herë në 10 ditë. Ata u shprehën se kjo ishte shumë pak, sidomos në verë. Kjo situatë bie në kundërshtim me rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit”, nr.3750/2 dt.23.7.2003, neni 13/2, “Higjiena personale”.

Në një numër të konsiderueshëm vendesh paraburgimi të vëzhguara ushqimi i siguruar në këto institucione ishte i pakonsu-mueshëm.

Sipas rregullores së miratuar nga Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë është përcaktuar se norma ushqimore për çdo person në paraburgim duhet të jetë 2700 kkal. Nga vëzhgimet rezultoi se ushqimi që servirej në këto institucione ishte larg kësaj norme dhe personat e paraburgosur e kompenonin atë me ushqimin e thatë që u sillnin familjarët.

Sipas personelit të këtyre institucioneve, cilësia e ulët e ushqimit justifikohet me fondin e vogël të caktuar për këtë zë në buxhet. KShH-ja thekson se situata e përshkruar këtu vjen në kundërshtim me rregulloren “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit” nr. 3750/2, datë 23.7.2003, kapitullin IV të saj, nenin 17, “Ushqimi i të paraburgosurve” si dhe me nenin 19, “Kontrolli dhe cilësia e ushqimit”, ku kërkohet që për çdo ushqim të gatuar të merret kampioni, për të verifikuar cilësinë e gatimit të ofruar në këto institucione. Gjithashtu, për të paraburgosurit e sëmurë duhet bërë trajtimi me dietë të veçantë, të miratuar nga specialisti i policisë me kërkesë të mjekut, por, siç është paraqitur edhe më lart, këto dispozita nuk janë zbatuar në asnjë rast.

### 1.4 Kapaciteti i dhomave të paraburgimit

Me gjithë transferimet e një numri të madh të të dënuarve me vendim të formës së prerë të gjykatës, në korrik 2004, mbipopullimi ishte i pranishëm pothuajse në të gjitha vendet e paraburgimit të vëzhguara.

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Bazuar në të dhënat e vëzhgimit në këto institucione<sup>6</sup>, numri i personave të mbajtur në një qeli ishte rreth dyfish në krahasim me kapacitetin e lejuar të dhomave të paraburgimit.

Mbipopullimi ka ndihmuar në mosgarantimin e kushteve higjieno-sanitare dhe në përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, siç ishte rasti i komisariatit të Durrësit etj.

### 1.5 Dhomat e ajrimit dhe ajrosja

Infrastruktura e dhomave të ajrimit në vendet e paraburgimit ishte larg standardeve të pranuar. Ato ishin të parikonstruktura dhe të paljera. Në komisariatet e policisë të Elbasanit, Vlorës, Krujës, Durrësit etj., dhomat e ajrimit ishin të pambuluara nga lart dhe nëkohë me reshje shiu futej brenda dhe të paraburgosurit qëndronin aty në shi. Kjo kishte shkaktuar shpeshherë sëmundje të lehta të të paraburgosurve. Në ndonjë komisariat, si në Shkodër, dhomat e ajrimit ishin të vogla, kurse në komisariatet e Elbasanit dhe të Fierit kishte vetëm një dhomë ajrimi e cila, po të mbahet parasysh numri i të paraburgosurve, nuk ishte e mjaftueshme.

Neni 15/1 i rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit”, nr.3750/2, datë 23.7.2003, siguron që “personat e paraburgosur dalin për ajrosje një herë në ditë në vendin e caktuar brenda orës 9.00 deri në 15.00. Koha e ajrimit për çdo të paraburgosur në grup është një deri në dy orë në ditë sipas grafikut të përpiluar nga specialisti i policisë së paraburgimit”, ndërkohë që me ligj është përcaktuar se koha e ajrimit është jo më pak se 2 orë në ditë dhe se kjo kohë mund të kufizohet vetëm për shkaqe të jashtëzakonshme.

Pothuajse në të gjitha komisariatet e vëzhguara, koha e ajrimit nuk respektohej. Drejtuesit me të cilët kontaktuan grupet e vëzhgimit, pohuan se kjo situatë ishte rrjedhojë e mbipopullimit.

### 1.6 Mbajtja e të dënuarve me vendim të formës së prerë

---

<sup>6</sup> Shih shtojcën për kapacitetet dhe gjendjen aktuale të komisariateve të vëzhguara.

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

KShH-ja ka vlerësuar masat e menjëhershme të ndërmarra nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve gjatë periudhës korrik – dhjetor 2004 për transferimin e të dënuarve me vendim të formës së prerë nga komisariatet e policisë në institucionet përkatëse të riedukimit. Këto masa kanë ulur nivelin e mbipopullimit në komisariate.

Megjithatë, në disa komisariate kishte të dënuar me vendim të formës së prerë. Kështu, në periudhën e vëzhgimit, në komisariatet e policisë të Fierit kishte 12 të dënuar të cilët qëndronin në dhomat e paraburgimit pas marrjes së dënimit me vendim të formës së prerë, në Krujë 6, Elbasan 12, Korçë 14, Durrës 24, Shkodër 5 dhe Mat 6. Mbatja e personave të dënuar në paraburgim cenon rëndë ligjin dhe të drejtat e tyre.

Nga verifikimet e dokumentacionit rezultoi se urdhri i ekzekutimit për dënimet me burgim në përgjithësi ishte nxjerrë nga organi i prokurorisë dhe se të dënuarit ishin njohur me të. Në shumicën e rasteve ky urdhër nuk i ishte njoftuar mbrojtësit të të dënuarit ose mbrojtësit të caktuar nga prokurori. Prokuroria nuk ka vepruar në përputhje me nenin 22, pika 4, të ligjit nr. 8331, datë 21.4.1998, "Për ekzekutimin e vendimeve penale", pasi kjo e fundit duhet të komunikonte me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në urdhrin e ekzekutimit duhet të përcaktohej lloji i institucionit.

Nga vëzhgimet rezultoi se kjo kërkesë e ligjit nuk ishte pasqyruar në asnjë urdhër ekzekutimi të vendimeve penale të formës së prerë. Në rast se kjo dispozitë ligjore do të respektohej, transferimi i personave të dënuar me vendim të formës së prerë në institucionet e riedukimit do të zgjidhej shumë shpejt.

Këtë çështje KSHH-ja e ka trajtuar disa herë, edhe më parë. Vëmë në dukje se letrën dërguar nga KSHH-ja Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve e trajtoi me seriozitet dhe mori masa të menjëhershme për të transferuar në vendet e vuajtjes së dënimit një numër të dënuarish me vendim të formës së prerë. KSHH-ja nxiti këtë institucion të veprojë me të njëjtin seriozitet për të tërhequr të gjithë personat me vendim të formës së prerë që gjenden aktualisht në vendet e paraburgimit.

### **1.7 Informimi i të drejtave në çastin e ndalimit ose të arrestimit**

Me gjithë përmirësimet e bëra, të paraburgosurit pretendojnë se, në çastin e ndalimit ose të arrestimit, nuk ishin njohur me të drejtat e tyre dhe nuk kishin pasur mbrojtës. Ata kishin pasur avokatë vetëm kur ishin marrë të pandehur. Raste të tilla janë pretenduar nga personat e kontaktuar në komisariatet e Elbasanit, Korçës, Shkodrës, Fierit, Lezhës, Beratit etj. Zakonisht ata ishin njohur me të drejtat e tyre kur u ishte siguruar avokati mbrojtës nga familjarët e tyre dhe rrallë nga vetë personeli i institucionit ku ata qëndronin.

Neni 6 dhe neni 463/2 i Kodit të procedurës penale parashikojnë se, kur personi nuk ka mjete të mjaftueshme, atij i sigurohet mbrojtja ligjore falas me avokatë të caktuar kryesisht. Të paraburgosurit e intervistuar nuk kishin besim tek avokatët e caktuar kryesisht nga shteti dhe cilësia e shërbimit të tyre.

### **1.8 Shërbimi shëndetësor**

Në vendet e paraburgimit të vëzhguara nga KShH-ja shërbimi shëndetësor për të paraburgosurit linte shumë për të dëshiruar. Në pjesën më të madhe të dhomave të paraburgimit, shërbimi shëndetësor nuk realizohej çdo 24 orë në ditë, ashtu siç është parashikuar në dispozitat ligjore, por të paraburgosurit vizitoheshin vetëm me kërkesën e tyre. Kjo vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 33 të ligjit i cili thotë që shërbimi mjekësor sigurohet gjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucion, pavarësisht nga kërkesat e të dënuarve, si edhe të nenit 36 të rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit”, nr.3750/2, datë 23.7.2003: “T’u sigurohet shërbim shëndetësor 24-orësh nën kujdesin e mjekut dhe, për shërbime më të specializuara, të trajtohen në qendrën spitalore të burgjeve”.

Gjatë intervistave të marra me të paraburgosurit doli në pah se ata e kërkonin shpesh shërbimin e mjekut në varësi të nevojave dhe të shqetësimeve shëndetësore të tyre. Ata ankoreshin për probleme me

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

aparatin e frymëmarrjes (ftohje, astmë) që e shpjegonin me vetë gjendjen e rënduar të mjedisit në dhoma, probleme me aparatën gastro-intestinal (dhembje stomaku, diarre), për të cilat shkaktare, sipas tyre, ishte cilësia e dobët e ushqimit si edhe prishja e ushqimeve ngaqë nuk kishin një vend të posaçëm për të mbajtur ushqimet që u sillte familja. Ankoheshin, gjithashtu, edhe nga dhembja e veshkave.

Në strukturën e këtyre vendeve të paraburgimit kishte mjek me kohë të plotë, por nga vëzhgimi rezultoi se në disa vende paraburgimi mjeku mungonte, si p.sh. në Vlorë, Kukës, Lezhë, Fier e Krujë. Në këto raste shërbimi shëndetësor realizohej nga ndihmësmjeku, kur kishte një të tillë, ose nga mjeku i urgjencës së spitalit të qytetit. Një pjesë e komisariateve, si: Shkodra, Elbasani, Gjirokastra etj., kishin në organikën e personelit një mjek i cili mbulonte qarkun përreth, kështu që puna e tyre vështirësohej nga mbingarkesa. Në këto komisariate nevojitej edhe një infermier ose ndihmësmjek.

Problem shqetësues mbetej edhe mungesa e theksuar e ilaçeve si edhe e bazës materiale të nevojshme. Në vendet e paraburgimit të Krujës, Vlorës, Korçës, Matit, Elbasanit, Durrësit, Beratit mungonin ilaçet bazë. Kishte edhe raste flagrante, si rasti i komisarariatit të Matit, ku mjeku kishte një vit që nuk merrte furnizime me barnat më të nevojshme mjekësore. Në disa komisariate të vëzhguara u gjetën ilaçe të cilave u kishte kaluar afati i skadencës.

Sipas personelit mjekësor të vendeve të paraburgimit, në listën e barnave të dërguara nga Ministria e Rendit Publik shumë nga ilaçet nuk gjendeshin.

Në disa vende paraburgimi, të paraburgosurit e intervistuar pohuan se ilaçet i mbanin vetë në dhomë. Kjo gjendje vjen në kundërshtim me rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit", nr.3750/2, datë 23.7.2003, kapitullin V, nenin 24 "Medikamentet mjekësore", që përcakton se trajtimi me barna mjekësore bëhet nga farmacia, ato përdoren me leje të mjekut, mbahen veças dhe hapen sipas porosive të mjekut.

Në komisarariatet e Krujës, Fierit dhe Matit nuk kishte dhomë të veçantë ku të bëheshin vizitat mjekësore. Ato realizoheshin në dhomat që përdreshin për takimet e të paraburgosurve me avokatët ose në

dhomën e përgjegjësit të dhomave të paraburgimit. Në komisariatit e Gjirokastrës mungonte ambulanca për lëvizjen e të sëmurve në spital.

Problem tjetër tepër shqetësues ishte mbajtja e të sëmurëve kronikë dhe e të sëmurëve mendorë në të njëjtat mjedise me të paraburgosurit e tjerë (komisariati i Durrësit). Në rastet e sëmundjeve ngjitëse kjo çonte në përhapjen e këtyre sëmundjeve tek të paraburgosurit e tjerë.

Me përjashtim të institucionit të paraburgimit nr. 313, Tiranë, ku ky shërbim sigurohej brenda mjediseve të veta, në komisariatet e tjera ai realizohej nga shërbimi ambulator jashtë mjediseve të paraburgimeve të vëzhguara.

### **1.9 E drejta e informacionit, e ushtrimit të riteve fetare dhe e aktiviteteve zbavitëse**

Në të gjitha dhomat e paraburgimit të vëzhguara, me përjashtim të institucionit të paraburgimit nr. 313, Tiranë, nuk lejohej asnjë libër, revistë, materiale informuese, qoftë edhe ndonjë material fetar. Personave të paraburgosur nuk u lejohej të mbanin as letër e laps. Nuk kishte biblioteka, as mjedise ku të paraburgosurit të ushtronin ritet fetare. Ata e kalonin kohën duke qëndruar shtrirë dhe duke biseduar me njëri-tjetrin. Në të gjitha komisariatet, pjesa më e madhe e të paraburgosurve të intervistuar pohuan se i kishin humbur lidhje me realitetin.

Personeli i paraburgimit e shpjegonte këtë situatë me faktin se nuk e lejonte rregullorja nr. 1075 e Ministrisë së Rendit. Vlen të theksohet edhe një herë se ekzistojnë mospërputhje midis rregullores që zbatohet, asaj “Për sigurimin dhe trajtimin e të paraburgosurve”, nr.1075, datë 15.9.1999, dhe ligjit nr. 8328, datë 16.4.1988, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” neni 41 (të sipërcituar). Konkretisht, në kapitullin V të rregullores së Ministrisë së Rendit, “Regjimi dhe jetesa në dhomat e paraburgimit”, pika 15, thuhet: “Të paraburgosurve do t’u jepet letër edhe laps vetëm me leje me shkrim të oficerit të policisë gjyqësore ose prokurorit...” Në lejen e dhënë përcaktohet sasia e letrës, e lapsit dhe koha e mbajtjes së tyre, në një kohë që neni 36 i rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit”,



nr.3750/2, datë 23.7.2003, “Të drejtat e të paraburgosurve”, thotë se i paraburgosuri “ka të drejtën t’u drejtojë ankesa dhe kërkesa drejtorisë së paraburgimit, organeve shtetërore e joshtetërore dhe të marrë përgjigje, të marrë pjesë në aktivitetet zbavitëse që organizohen në regjimin e brendshëm dhe të lexojë libra artistikë apo fetarë, ose të luajë me letra tavoline, pa bërë zhurmë...Të ushtrojë besimin fetar”.

Në nenin 75 të ligjit citohet: “Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj të arrestuarve dhe të ndaluarve, duke respektuar kufizimet e vendosura për ta me ligje të tjera”. Në nenin 41 të po këtij ligji, të dënuarit lejohen të mbajnë gazeta, revista e libra që janë në shitje të lirë jashtë.

### **1.10 Puna edukative me personat e arrestuar në vendet e paraburgimit**

Në komisariatet e vëzhguara, me përjashtim të institucionit të paraburgimit 313, Tiranë, me personat e arrestuar nuk zhvillohej asnjë lloj pune edukative, nuk ekzistonin programe edukimi si edhe mungonte personeli i specializuar për të përmbushur këtë funksion. Kështu, në asnjë paraburgim në varësi të Ministrisë së Rendit Publik nuk kishte edukator apo psikolog që të merrej me edukimin e të paraburgosurve të cilët të gjithë kohën e tyre e kalonin brenda dhomave të vogla të paraburgimit, pa bërë asgjë.

Në institucionin e paraburgimit nr. 313, Tiranë, punonin 3 edukatorë që merreshin me punën edukative me të paraburgosurit. Të paraburgosurat femra kishin edukatoren e tyre e cila kishte komunikime të shpeshta me to, ndërsa për të paraburgosurit e mitur kishte edhe një psikologe të vënë në dispozicion nga një organizatë jofitimprurëse. Të paraburgosurit në këtë institucion, sidomos të miturit dhe gratë, zhvillonin aktivitete të ndryshme kulturore, sportive, fetare dhe edukuese. Megjithatë, puna edukuese nuk realizohej plotësisht për shkak të mbipopullimit të këtij institucioni. Gjithashtu, për formimin kulturor të të paraburgosurve funksiononte edhe biblioteka, e cila kishte nevojë për t’u pasuruar me libra të rinj. Për të miturit dhe gratë zhvilloheshin kurse të gjuhës angleze. Në këtë institucion kishte 2 fusha minifutbolli në

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

gjendje shumë të mirë, të cilat ishin bërë me sponsorizime private dhe përdorshin për aktivitete sportive dhe zbavitëse të të paraburgosurve.

### 1.11 Përdorimi i dhunës

Gjatë vëzhgimeve të kryera, pati të paraburgosur që pretendonin për përdorim dhune nga ana e personelit të paraburgimit, por të paraburgosurit e kontaktuar nuk paraqitën ankesa me shkrim për dhunën e ushtruar ndaj tyre. Një pjesë kishin frikë të bënin kallëzim dhe një pjesë nuk kishin dijeni për të drejtën e ankimit në rast të përdorimit të dhunës.

Personeli i dhomave të paraburgimit mohoi të ketë pasur raste të përdorimit të dhunës ose të keqtrajtimit të të paraburgosurve. Në shumicën e rasteve të paraburgosurit pretendonin se dhunë ndaj tyre është ushtruar në momentin e arrestimit apo të ndalimit nga punonjësit e rendit, nga oficerët e policisë gjyqësore ose edhe nga prokurori për pranim të akuzës së bërë.

### 1.12 Takimet me familjarët

Për sa u përket takimeve me familjarët, në të gjitha vendet e paraburgimit të vëzhguara ato realizoheshin 1 herë në 10 ditë, ndërsa për personat në gjykim takimet bëheshin me urdhër të prokurorit. Të paraburgosurit në përgjithësi u ankuan për kohën e shkurtër të takimeve të tyre me familjarët për arsye se dorëzimi i ushqimeve reduktonte kohën e takimeve.

### 1.13 Trajtimi i personave të mitur të arrestuar

Në paraburgimet e vëzhguara, numri i të miturve të paraburgosur varioje 6 – 8 të paraburgosur, ndërkohë që në institucionin nr. 313, Tiranë, gjatë periudhës së vëzhgimit, ndodheshin 20 të mitur. Të miturit akuzoheshin për vepra penale, si: vjedhje automjeti, shitje të farave të bimëve narkotike, plagosje etj.

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Të miturit e kontaktuar informuan grupet e vëzhgimit se ata janë pyetur pa avokat. Kjo gjendje ka ndryshuar në momentin kur janë marrë në pyetje nga prokurori dhe kur është bërë vleftësimi i masës së sigurimit në gjykatë.

Megjithëse personeli i paraburgimit ishte në dijeni të nevojës së trajtimit të veçantë të të miturve, nga vëzhgimet rezultoi se, me përjashtim të paraburgimit 313, Tiranë, pothuajse në të gjitha vendet e paraburgimit të vëzhguara nuk kishte seksione të veçanta për të miturit në paraburgimet e vëzhguara. Të miturit mbaheshin në qeli me elementë që paraqitnin rrezikshmëri të madhe shoqërore. Raste të tilla u konstatuan në Fier ku të miturit ndodheshin në një dhomë me persona të rritur të akuzuar për vrasje.

Nga vëzhgimet rezultoi se nuk kishte asnjë program lidhur me punën edukative me të miturit si edhe as personel të specializuar për t'u marrë me edukimin e tyre (duke përjashtuar këtu paraburgimin nr. 313, Tiranë).

Siç është trajtuar edhe më parë në këtë raport, edhe për të miturit nuk lejohej asnjë libër, revistë a ndonjë material fetar. Ata gjithë kohën e kalonin në paraburgim pa asnjë lloj aktiviteti. Personeli i paraburgimit zbatonte rregulloren nr.1075, datë 15.9.1999, "Për sigurimin dhe trajtimin e të paraburgosurve".

Arsimimi i të miturive të arrestuar të cilët nuk kishin mbaruar shkollën për shkak të izolimit të tyre, ishte realizuar vetëm në institucionin e paraburgimit nr. 313, Tiranë<sup>7</sup>.

Në të gjitha komisariatet e vëzhguara, të miturit ishin të izoluar dhe nuk ishin marrë masa për të zhvilluar ndonjë lloj trajtimi të veçantë për arsimimin e tyre.

Trajtimi i të miturve nga personeli i paraburgimit ishte i njëjtë me trajtimin e të rriturve duke cenuar në këtë mënyrë standardet e përcaktuara në aktet e ndryshme ndërkombëtare dhe në legjislacionin shqiptar.

Për sa i takon së drejtës së informimit, të miturit mbanin kontakte me familjarët, por nuk kishin mundësi të tjera informimi.

---

<sup>7</sup> Një shembull pozitiv i trajtimit të të miturve është institucioni i paraburgimit 313, Tiranë. Kjo gjë është përmendur në këtë raport tek pjesa e punës edukative në vendet e paraburgimit.

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Për shërbimin mjekësor, disa të mitur të intervistuar në Fier, Krujë etj. u shprehën se ilaçet i merrnin nga familjarët dhe se mjeku nuk i takonte. Problem për të miturit në të gjitha paraburgimet ishte shërbimi stomatologjik. Janë raportuar raste ku të miturit kishin kërkuar shërbim stomatologjik dhe ai nuk u ishte siguruar nga personeli në paraburgim (rasti i paraburgimit të Beratit). Këto raste janë shkelje flagrante të së drejtës së tyre për të përfituar shërbim shëndetësor.

### 1.14 Trajtimi i femrave të paraburgosura

Menjëherë pas ndalimit ose arrestimit të tyre, femrat mbahen në dhomat e paraburgimit të komisariateve deri në momentin e vendosjes së masës së sigurimit nga gjykata (neni 245 i K.pr.p.). Mbasi është caktuar masa e sigurimit arrest në burg, ato dërgohen në seksionin e veçantë për gratë, në paraburgimin nr. 313, Tiranë.

Nga vëzhgimet e kryera në vendet e paraburgimit ka rezultuar se nuk kishte një dhomë të veçantë për gratë, ashtu siç e parashikon ligji. Sipas personelit në vendet e paraburgimit, në rastet kur ndalohet një person i seksit femër, lirohet njëra nga dhomat e paraburgimit të meshkujve, gjë që çon në rritjen e numrit të të paraburgosurve nëpër dhomat e tjera.

Në paraburgimet e vëzhguara në përbërjen e personelit që shërbente kishte vetëm burra. Nuk kishte personel sigurie femër dhe as personel të posaçëm për trajtimin e femrave të paraburgosura. Grupi i vëzhgimit evidentoi një praktikë të tillë në paraburgimin e Beratit.

Femrat e paraburgosura nuk kishin informacion për njohjen e të drejtave procedurale në momentin e ndalimit ose të arrestimit. Niveli i tyre arsimor, mungesa e komunikimit me familjen në momentet e para të hetimit si edhe mospasja e një avokati në këto momentet janë faktorë që kanë çuar në mosnjohjen e të drejtave të tyre. Puna edukative në vendet e paraburgimit ndryshonte kur ato transferoheshin në institucionin e paraburgimin nr. 313, Tiranë.

Gjatë periudhës së vëzhgimit, në këtë institucion gjendeshin 39 të paraburgosura. Trajtimi i tyre ndryshonte nga pjesa tjetër e meshkujve të paraburgosur. I kushtohej rëndësi shërbimit mjekësor, respektoheshin

---

---

**Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje**

kushtet e ajrimit. Në këtë institucion kishte një serë me lule ku ato mund të punonin. Kishin mundësi informimi nëpërmjet televizorit dhe komunikimeve të vazhdueshme me edukatoren e institucionit.

## RESPEKTIMI I TË DREJTAVE NË INSTITUCIONET E VUAJTJES SË DËNIMIT

# 2

### 2.1 Infrastruktura dhe kushtet fizike të institucioneve të vuajtjes së dënimit

Krahasuar me të dhënat e një periudhe të mëpashme<sup>8</sup>, në disa burgje rezultoi se ka përmirësime. Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kanë vepruar në dy drejtime të rëndësishme: së pari, në ndërtimin dhe hapjen e burgjeve të reja, si burgu i Peqinit<sup>9</sup>, në ndërtimin e një çerdheje për fëmijët e grave që vuajnë dënimin në

---

<sup>8</sup> Vëzhgimi i mëparshëm i KShH -së është organizuar në vitin 2001.

<sup>9</sup> Megjithatë, edhe në rastin e burgut të Peqinit, KShH -ja është shprehur edhe më parë, se mund të ishin marrë masat qysh në ndërtimin e këtij institucioni që infrastruktura e tij, si p.sh. tualetet, të ishin ngritur brenda dhomave të të dënuarve. Kjo do të shmangte problemet të cilat mund të krijohen si pasojë e tualeteve të përbashkëta të të dënuarve.

paraburgimin 313, Tiranë, si dhe në përmirësimin e infrastrukturës së burgjeve ekzistuese.

Në burgjet e vëzhguara, mjediset tashmë kishin pajisje të reja dhe kushte higjienike përgjithësisht të mira. Megjithatë, në disa nga këto burgje, si në burgun nr. 302, Tiranë, në burgun e Vaqarit, të Rrogozhinës, në spitalin e burgut etj., kishte probleme me infrastrukturën. Ato trashëgonin një infrastrukturë të vjetër, pasi ishin ndërtuar rreth 70 vjet më parë. Ndërtesat e disa prej tyre ishin me lagështirë, për rrjedhojë edhe kushtet në këto ndërtesa ishin të rënda dhe larg standardeve të pranuara. Në mjediset e brendshme të disa burgjeve, si në burgun nr. 302, Tiranë, nuk kishte ndriçim natyror, ndërtesa kishte një mënyrë ndërtimi të tillë që rrihej shumë pak nga dielli dhe ishte e errët. Në institucionin e riedukimit nr. 325, zyrat e personelit, dhoma e mjekut, e dentistit dhe farmacia ishin të vendosura në baraka të përshtatura për zyra. Në dimër ato mbusheshin me ujë. Mungesa e kushteve optimale për të punuar ishte një faktor që vështirësonte punën e personelit të këtij institucioni. Kushtet e këqija u vunë re edhe në dhomat e izolimit, dritaret e të cilave nuk kishin xhama, si në burgun e Vaqarit. Për sa i përket gjendjes në spitalin e burgut, grupi i vëzhgimit konstatoi se kishte një dallim të dukshëm midis dhomave dhe mjediseve të personelit të cilat ishin në gjendje të mirë, të mobiluara dhe në kushte higjienike të mira në krahasim me dhomat e të sëmurëve ku mungonin edhe mobiljet më të domosdoshme, si krevetet, komodina, tavolina. Edhe kur orenditë ekzistonin, ato ishin shumë të vjetruara.

## 2.2 Mjediset e qëndrimit dhe të fjetjes

Neni 23/2 i ligjit të mësipërm siguron se “Ndërtesat ekzistuese përshtaten gradualisht për t’u përdorur me ndarje të veçanta, nga grupe të dënuarish në numër sa më të kufizuar, ndërsa projektet e ndërtesave të reja miratohen për ndarje të përdorshme deri në 4 të dënuar, duke respektuar kubaturat e nevojshme”. Gjithashtu, Rregullorja e përgjithshme e burgjeve nr. 63, datë 9.3.2000, që ka dalë në zbatim të këtij ligji, në nenin 21 të saj parashikon se në strehimin e të dënuarve duhet të

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

mbahet parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo burgju, por në çdo rast duku u siguruar kubatura jo më pak se 4m<sup>2</sup> për çdo të dënuar.

Në bazë të vëzhgimeve të kryera në burgje, në përgjithësi mund të thuhet se mbipopullimi ishte problem në disa burgje. Për shkak të mbipopullimit, në burgun e Vaqarit, 12 persona në dhomë ishin të detyruar të flinin në dysheme. Për fjetje ishin shfrytëzuar edhe hapësirat e mensës, si në burgun nr. 325, Tiranë. Gjithashtu, mbipopullimi në burgje përkeqësonte kushtet higjienike në këto mjedise si edhe e vështirësonte punën e personelit i cili me gjithë shtimin e numrit të të dënuarve kishte mbetur me të njëjtën strukturë organike të mëparshme.

Hapësirat në dhomat ishin të pamjaftueshme dhe nuk mundësonin veprimtari çlodhëse. Problem mbetej edhe sigurimi i ndriçimit të nevojshëm natyror dhe atij artificial në dhomat e të dënuarve. Ky problem u vu re në burgun e Rrogozhinës, të Bënçës, në burgun nr. 302 Tiranë. Megjithatë, kishte edhe shembuj inkurajues, si mjediset e reja, dhomat e pajisura me mobilie të reja dhe në kushte higjienike të mira, në burgun e Peqinit dhe të Tepelenës.

### 2.3 Veshja dhe pajisjet

Në të gjitha burgjet e vëzhguara veshjet personale të të dënuarve siguroheshin nga familjarët e tyre. Kjo bie në kundërshtim flagrant me nenin 25 të ligjit nr.8328, dt.16.4.1988, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim", i cili thotë se: "Çdo të dënuari i sigurohet veshmbathje dhe pajisje individuale në sasi të mjaftueshme, në gjendje të mirë dhe të pastër, që të sigurojnë plotësimin e kërkesave normale të jetesës". KShH-ja është i vetëdijshëm se pajisja e të dënuarve me veshje të institucionit shoqërohet me një kosto financiare, megjithatë i rekomandon Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të marrë masa që veshjet të sigurohen nga institucioni. Këtu kemi parasysh edhe faktin se shumë të dënuar mund të mos kenë burime financiare të mjaftueshme për të siguruar veshmbathjen individuale dhe për të pasur një paraqitje të respektueshme dhe normale.



## 2.4 Higjiena vetjake dhe e mje disit

Edhe pajisjet dhe mjetet e nevojshme për higjienën vetjake të të dënuarve, si p.sh. furçë, pastë dhëmbësh etj., siguroheshin nga familjarët. Kjo bie ndesh me nenin 26 të ligjit të mësipërm sipas të cilit institucioni i vuajtjes së dënimit u siguron të dënuarve mjediset, pajisjet dhe mjetet e nevojshme për pastërtinë vetjake, në përpjesëtim me numrin e përdoruesve, që të garantojnë në mënyrë sa më optimale higjienën vetjake”. Gjithashtu, në kundërshtim me të njëjtin nen të ligjit të sipërpërmendur, ku thuhet se institucioni siguron shërbime periodike të pastrimit të mjediseve, dhomat e të dënuarve në disa burgje të vëzhguara nuk ishin të pastra, p.sh., dhomat e burgut të Rrogozhinës. Nga intervistat me të dënuar rezultoi se familjarët u siguronin edhe detergjentë për të siguruar pastërtinë e këtyre mjediseve.

Faktorë që ndikonin në higjienën jo të mirë të dhomave ishin sipërfaqja shumë e vogël e dhomave, mungesa e ajrimit të tyre, dritaret e vogla, lagështira e vetë ndërtesës, mbipopullimi i dhomave, mungesa e detergjentëve për pastrim, gatimi brenda dhomave të të dënuarve, mungesa e mjediseve të veçanta për mbajtjen e ushqimeve të të dënuarve etj. Kushtet e mjediseve të tualeteve dhe dushet ishin problematike në disa burgje, por vëzhguesit e KShH-së raportojnë një gjendje tepër të rëndë në këtë drejtim në burgun e Krujës.

## 2.5 Ushqimi

Pjesa më e madhe e të dënuarve të intervistuar u ankuan për cilësinë e ushqimit të siguruar nga institucionet e vuajtjes së dënimit. Sipas tyre, ushqimi ishte i keq dhe pothuajse nuk e konsumonin atë. Kërkesat e tyre i plotësonin me ushqimet e sjella nga familja ose me ato që blinin në dyqanin e institucionit. Gjithashtu, nga vëzhgimi rezultoi se mungonin mjedise të veçanta për të ngrënë dhe për të mbajtur ushqimet që të dënuarve ua sillnin familjarët. Kjo situatë bie ndesh me kërkesat e nenit 27 të ligjit sipas të cilit: “Të dënuarve u sigurohet ushqim i bollshëm dhe i mjaftueshëm, i përshtatshëm me moshën dhe gjendjen

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

shëndetësore të tyre. Ushqimi, si rregull, përgatitet dhe jepet në mjedise të caktuara për këtë qëllim”.

Një tjetër shqetësim ishte uji dhe cilësia e tij. Shumë nga të dënuarit e intervistuar në institucionin nr. 302, në burgun e Vaqarit etj. u ankuan se uji vinte shumë i turbullt, i kuq dhe se ishte e i papijshëm. Për rrjedhojë, të dënuarit ishin të detyruar të blinin ujë të pijshëm. Personeli i këtyre institucioneve, i pyetur për këtë problem nga vëzhguesit e KShH-së, pohoi se nuk ishte bërë ndonjë analizë për verifikimin e cilësisë së ujit në institucionin e tyre.

## 2.6 Koha e ajrimit

Neni 28 i ligjit sanksionon se: “Të dënuarit që nuk punojnë jashtë dhe të gjithë të dënuarit e tjerë, kanë të drejtë të qëndrojnë në ajrim në mjedise të hapura jo më pak se 2 orë në ditë dhe vetëm për shkaqe të jashtëzakonshme kjo kohë mund të reduktohet, por gjithmonë jo më pak se 1 orë në ditë”. Bazuar në verifikimet e bëra nga vëzhguesit e KShH-së, kishte pasur raste kur ky minimum ligjor nuk ishte respektuar. Kjo si rezultat i disa faktorëve, si mbipopullimi në burgje dhe mjediset e pakta për ajrim që kishin institucionet e vuajtjes së dënimit. Në përgjithësi, të dënuarit e intervistuar ngritën disa probleme, si kohën e shkurtër për ajrim, veçanërisht në kushtet e mungesës së aktiviteteve të ndryshme sportive e edukative brenda institucionit të vuajtjes së dënimit. Në burgun nr. 302, Tiranë, mungonin mjediset e ajrimit jashtë ndërtesës.

Problem tjetër i ngritur nga të dënuarit e burgut të Vaqarit ishte se, në ditë festash, ata nuk mund të dilnin në ajrim për shkak të numrit më të vogël të personelit.

Sipas drejtuesve të këtyre institucioneve, një faktor frenues në përmbushjen e detyrimeve ligjore në trajtimin e personave të dënuar lidhur me të drejtën e ajrosjes, ishte mbipopullimi.

## 2.7 Shërbimi shëndetësor

Sipas nenit 33 të ligjit, “Shërbimi mjekësor sigurohet gjatë gjithë kohës së qëndrimit në institucion, pavarësisht nga kërkesat e të dënuarve”, ndërsa, sipas nenit 30 të Rregullores së përgjithshme të burgjeve, drejtoria e burgut organizon shërbim shëndetësor 24-orësh në institucion. Ndërkohë, vëzhguesit e KShH-së sollën raste ku mjeku nuk kryente vizita periodike të të dënuarve, por i vizitonte ata vetëm me kërkesë të tyre. Në fundjavë nuk kishte mjek dhe të dënuarit, për t’u vizituar, ishin të detyruar të prisnin ditën e hënë, si p.sh. në burgun 302, Tiranë.

Për personelin e sektorit shëndetësor përgjithësisht nuk kishte probleme me përjashtim të burgut të Krujës ku kishte mungesa në këtë sektor. Prej një viti mungonin 2 mjekë dhe 1 psikiatër, nevojat e të cilëve mbuloheshin nga mjekë të qytetit. Në këtë institucion edhe kabineti i shërbimit stomatologjik ishte i mbyllur.

Një tjetër problem i evidentuar gjatë vëzhgimeve ishte furnizimi i institucioneve të riedukimit me ilaçe. Megjithëse në nenin 29 të ligjit parashikohet se është detyrë e administratës së institucionit në bashkëpunim me spitalin e burgjeve dhe me organet kompetente shtetërore të shëndetësisë të garantojnë furnizimin me ilaçe dhe me pajisjet mjekësore, vëzhgimet evidentuan një sërë vonesash në furnizimin e këtyre institucioneve me ilaçe.

Kërkesat për ilaçe nuk përmbusheshin në kohë në burgun nr. 302, 325, në burgun e Vaqarit, Krujës, Rrogozhinës, burgun e sigurisë së lartë Tepelenë. Kjo gjendje ishte krijuar si rezultat i moszhvillimit të tenderit për barnat mjekësore në kohën e duhur. Për këtë arsye të dënuarit ishin të detyruar t’i merrnin ilaçet nga familjarët e tyre, të cilat administroheshin nga institucioni.

Infrastruktura e mjediseve ku mbaheshin barnat mjekësore linte shumë për të dëshiruar në disa burgje. Në burgun nr. 325 Tiranë, farmacia ndodhej në kushte të një lagështire shumë të madhe.

Në disa burgje, si: në burgun e Tepelenës, Peqinit, burgun nr. 302, Tiranë, kishte mungesa të mjeteve të transportit, si autoambulanca në

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

rastet urgjente kur të dënuarit e sëmurë duheshin çuar në spital. Këtë problem e ngriti personeli shëndetësor i institucioneve të vëzhguara.

Problem tjetër shqetësues ishte trajtimi shëndetësor i femrave të dënuara. Në institucionin nr. 325, ku mbahen femrat e dënuara, nuk bëhej depistimi i rregullt i sëmundjeve polmonare të tyre, shërbim ky që më parë u sigurohej në këtë institucion; shërbimi gjinekologjik, gjithashtu mungonte. Në rast nevojë ato dërgoheshin në maternitetin e Tiranës.

Në lidhje me trajtimin e veçantë të të dënuarve të sëmurë mendorë dhe kronikë, gjatë vëzhgimeve të kryera u raportuan raste ku disa të sëmurë mendorë dhe kronikë qëndronin në të njëjtin mjedis me të dënuar të tjerë jo të sëmurë, si p.sh. në burgun e Rrogozhinës, të Vaqarit, në burgun nr. 325 Tiranë. Në burgun e Rrogozhinës, të sëmurëve mendorë dhe kronikë nuk u sigurohej trajtim i veçantë, i vazhdueshëm dhe afatgjatë me ilaçe.

Sipas nenit 16 të ligjit, për mjekimin e të dënuarve të sëmurë ose me shqetësime mendore ose psikike funksionojnë institucione mjekësore të posaçme ose seksione të veçanta në burgje ose në spitale jashtë sistemit të burgjeve. Për këtë çështje mund t'i referohemi edhe nenit 31 të Rregullores së përgjithshme të burgjeve ku parashikohet se në varësi të kushteve materiale dhe të infrastrukturës, institucioni i vuajtjes së dënimit dhe sistemi i burgjeve në tërësi duhet të marrin të gjitha masat për trajtimin e të dënuarve që vuajnë nga sëmundje dhe të meta të tjera mendore, në reparte e njësi të specializuara pranë sistemit të burgjeve apo për kurimin e tyre në institucione psikiatrike e mjekësore të specializuara për këtë qëllim.

Nga vëzhgimi i kryer në spitalin e burgut<sup>10</sup> u evidentuan një sërë problemesh të rënda të cilat Komiteti Shqiptar i Helsinkit i ka bërë edhe objekt të deklaratës së tij publike<sup>11</sup>. Shqetësues ishte fakti se në spitalin e burgut u gjendën 55 persona të sëmurë mendorë. Mbajtja e tyre në këtë

---

<sup>10</sup> Në këtë pjesë të raportit trajtohen probleme lidhur me të dënuarit e sëmurë mendorë që gjendeshin në këtë institucion gjatë vëzhgimeve të KShH-së. Për problemet e tjera të këtij institucioni të veçantë, lutemi të lexoni në faqen 24-25 të këtij raport.

<sup>11</sup> Për më gjerë, lexoni deklaratën e KShH-së "Gjendje e rëndë në spitalin e burgut, Tiranë", datë 24 nëntor 2004.

---

---

### Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

spital së bashku me të sëmurët e tjerë ishte shkelje e rëndë e nenit 82, pika 1, e dokumentit të Kombeve të Bashkuara “Tërësia e rregullave minimum për trajtimin e të burgosurve”, i cili sanksionon se personat me të meta nuk duhet të mbyllen në burgje si edhe duhet të merren masa për t’i transferuar ata sa më shpejt që të jetë e mundur në institucione për të sëmurë mendorë.

Vlen të përmendet se në trajtimin e të sëmurëve mendorë të deklaruar të papërgjegjshëm cenohet edhe ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale” (neni 45), sipas të cilit masat mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohen në institucionin mjekësor të specializuar..., si edhe ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” (neni 16), ku thuhet se personat e sëmurë ose me shqetësime mendore dhe psikike vendosen në institucione mjekësore të posaçme ose seksione të veçanta në burgje ose në spitale jashtë sistemit të burgjeve, që shërbejnë për mjekimin e tyre.

Mbajtja e të sëmurëve mendorë në spitalin e burgut ishte cenim i rëndë edhe i nenit 46, paragrafi i tretë i Kodit penal, i dli sanksion ndër të tjera se gjykata është e detyruar ta rishqyrtojë vendimin e saj me kalimin e një viti nga dita e dhënies së një mase mjekësore. Drejtuesit e institucionit pretenduan se gjykata nuk ka riparë vendimet e dhëna prej saj.

KShH-ja i është drejtuar edhe më parë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë duke kërkuar marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e kushteve në spitalin e burgut si dhe për transferimin e të sëmurëve mendorë në institucionet e specializuara, megjithatë situata vazhdon të jetë e njëjtë.

Personeli mjekësor për trajtimin e 13 personave të sëmurë mendorë, të paralizuar stacionarë, krejtësisht të paaftë për t’u kujdesuar për veten, ishte i pamjaftueshëm. KShH-ja ka shprehur mendimin se mbajtja e tyre në spitalin e burgut është e papërshtatshme. Ata kanë nevojë për trajtim të specializuar.

## 2.8 Pranimi dhe trajtimi i të dënuarve në institucionet e vuajtjes së dënimit

*Njohja e të dënuarve me të drejtat dhe detyrimet e tyre*

Në bazë të nenit 30 të ligjit, në momentin e parë të hyrjes në institucionin e vuajtjes së dënimit, i dënuari takohet me komisionin e pritjes të përbërë nga shefi i regjimit, mjeku, një edukator etj. Ata e njohin me të drejtat dhe detyrat e tija në institucion. Në dosjen e të dënuarit komisioni i pritjes mban një procesverbal, duke përfshirë zhvillimin e vizitës nga mjeku i burgut si edhe mjekimin e mundshëm. Kjo dispozitë ligjore gjente zbatim në burgun e Peqinit, Vaqarit, Tepelenës, Rrogozhinës, Krujës, në burgun nr. 325, Tiranë. Ndërsa në burgun nr. 302, Tiranë, të dënuarit e intervistuar pretendonin se kjo dispozitë nuk zbatohet plotësisht, pasi të dënuarit nuk i njihnin me të drejtat dhe detyrat e tyre në këtë institucion. Personeli i pyetur nga grupi i vëzhgimit i mohoi këto pretendime të të dënuarve.

Në përgjithësi, të dënuarit kërkonin më shumë informacion lidhur me të drejtat dhe detyrimet e tyre në institucionet e vuajtjes së dënimit.

## 2.9 Trajtimi i të dënuarve

Në përgjithësi, të dënuarit e intervistuar në burgun e Peqinit, Krujës, Tepelenës, në burgun nr. 325 Tiranë, në burgun e Vaqarit dhe të Rrogozhinës u shprehën se kishin marrëdhënie të mira me personelin e shërbimit. Ndërsa të dënuarit e intervistuar në burgun nr. 302 shprehën shqetësime për trajtimin nga personeli. Ata u ankuan për një komunikim verbal joetik dhe fyes, madje edhe për presione psikologjike të personelit me uniformë ndaj tyre. Të pyetur nëse ishin ankuar ndonjëherë për këtë sjellje te papranueshme dhe joetike te personelit, të dënuarit pohuan se ankesat e tyre ia kishin drejtuar përgjegjësit të shërbimit, por, me gjithë ankesat, sipas tyre, nuk ishte marrë asnjë masë konkrete nga drejtuesit e institucionit. Gjithashtu, ata pretendonin se gjatë kontrollit të dhomave,

grupi i gatshëm nuk respektonte dinjitetin njerëzor të tyre i cili sanksionohet në nenin 47 të ligjit të mësipërm ku i dënuari i nënshtrohet kontrolli vetjak në çdo rast të hyrjes dhe të daljes nga institucioni dhe në raste të tjera kur ka shkaqe të arsyeshme. Po sipas këtij neni, kontrolli vetjak bëhet duke respektuar dinjitetin e të dënuarit. Sipas të dënuarve të këtij burgu, grupi i gatshëm demonstroi një sjellje agresive dhe kërcënuese ndaj tyre. Megjithatë, grupi i vëzhgimit të KShH-së, pa paragjykuar pretendimet e të dënuarve, nuk kishte mundësi t'i verifikonte ato. Administrata e institucionit e pyetur për këto shqetësime të ngritura nga të dënuarit, nuk i pranoi ato si të mirëqena.

## 2.10 Punësimi i të dënuarve

Të dënuarve që vuajnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit, u njihet e drejta për punë. Në mbështetje të neni 34, 35 dhe 36 të ligjit si dhe të Rregullores së përgjithshme të burgjeve, puna nuk ka karakter dënimi dhe shpërblehet. Puna, kushtet e punës dhe caktimi i punës organizohet nga drejtoria brenda institucionit. Mund të sigurohen fronte pune edhe jashtë institucionit, por që, në praktikë, ende nuk është realizuar në asnjë nga institucionet e vuajtjes së dënimit në vendin tonë.

Në përgjithësi, numri i të dënuarve të punësuar në burgje ishte shumë i vogël, krejtësisht i papërfillshëm me numrin e përgjithshëm të tyre. Kështu, në këtë drejtim, mund të përmendim burgun e Vaqarit ku ishin të punësuar 36 nga 226 të dënuar, burgun e Rrogozhinës ku ishin të punësuar 90 nga 340 të dënuar, burgun e Peqinit ku ishin të punësuar 70 nga 650 të dënuar. Përgjithësisht, këta të dënuar punonin në mirëmbajtjen e institucionit, në kuzhinë, në lulishte, në pastrim mjedisi etj. Vlen të përmendet burgu i Rrogozhinës ku kishin ndërtuar një oficinë të vogël dhe një zdrukhtari ku ishin punësuar disa të dënuar.

Sipas personelit të burgut të Vaqarit, në këtë burg kishte shumë fusha dhe mundësi për punësimin e të dënuarve dhe, krahas kësaj, ata kishin edhe mbështetjen e biznesit për ta realizuar këtë. Megjithatë, deri në çastin kur u zhvilluan vëzhgimet nuk ishte realizuar asnjë projekt për punësimin e të dënuarve, megjithëse Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve kishte bërë disa studime fizibiliteti për të realizuar punësimin e të

dënuarve. Pengesa kryesore në këtë drejtim ishte mungesa e akteve normative që rregullojnë punësimin dhe shpërblimin e punës së të dënuarve.

Gjithashtu, problem mbetet edhe mënyra e shpërblimit të punës së kryer nga të dënuarit. Sipas të dhënave të marra në institucionet e vëzhguara, të dënuarit e punësuar përfitonin vetëm 4 ditë ulje dënimi dhe 90 lekë të rinj në muaj. Në këtë drejtim, mendojmë se duhen të fillojë zbatimi i strategjive konkrete për punësimin e të dënuarve në burgje, për thithjen e biznesit privat për të investuar në këtë fushë si edhe për ndryshimin e mënyrës së shpërblimit të tyre e cila duhet të jetë në përputhje me nivelin e pagesës që funksionon jashtë sistemit të burgjeve, në shoqërinë e lirë. Një gjë e tillë është parashikuar edhe në nenin 35 të ligjit të mësipërm ku thuhet se kushtet e punës duhet të jenë si në shoqërinë e lirë me qëllim që të dënuarit të përfitojnë aftësi profesionale për të lehtësuar riintegrimin e tyre në shoqëri. Kjo gjë do t'i vinte shumë në ndihmë jo vetëm riintegrimin të të dënuarve në shoqëri, por do të ndihmonte edhe gjendjen financiare të tyre dhe të familjarëve të tyre duke marrë në konsideratë që pjesa më e madhe e personave të dënuar kanë nivel shumë të ulët ekonomik.

## 2.11 Arsimimi i të dënuarve

Në burgje të dënuarve u njihet e drejta e arsimimit dhe e formimit kulturor dhe profesional me anë të organizimit të shkollës si dhe kurseve profesionale, sipas sistemeve në fuqi, ku kujdes i veçantë u kushtohet të dënuarve nën 25 vjeç (neni 37 i ligjit).

Në përgjithësi, puna edukative në burgje konsistonte në takime dhe biseda me personelin e sektorit edukativ për të diskutuar lidhur me shqetësimet e të dënuarve, këshillime psikosociale, takime në grup për të biseduar lidhur me tema të ndryshme, lojëra të ndryshme argëtuese, lojëra sportive etj. Shembull pozitiv për organizimin e punës edukative ishte burgu i Vaqarit dhe burgu nr. 325 Tiranë. Në to organizoheshin kurse kompjuteri, kurse të gjuhëve të huaja (anglisht, italisht) me mësues të jashtëm, kampionate shahu, futbollit, volejbollit dhe basketbollit si edhe veprimtari të tjera kulturore dhe sportive (konkurse piktore dhe letrare



---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

etj.). Në burgun e Vaqarit, për të dënuarit, ishte organizuar shkollë sipas programit të shkollës 9-vjeçare, ndërsa në burgun nr. 325, Tiranë, ishin ngritur kurse me mësues të jashëm, për të dënuarit analfabetë, si dhe kurse rrobaqepësie, për prerje flokësh etj., të ngritura këto me ndihmesën e shoqatave bamirëse fetare.

Në institucionin nr. 302, Tiranë, nuk kishin organizuar asnjë lloj kursi.

Në përgjithësi, nga vëzhgimet e kryera rezultoi se ekzistonin disa faktorë negativë që frenonin ose që vështirësonin organizimin e punës edukative sipas standardeve të kërkuara nga ligji, si p.sh., mbipopullimi i institucioneve të vuajtjes së dënimit dhe, nga ana tjetër, numri i kufizuar i punonjësve të sektorit të edukimit<sup>12</sup>, mungesa e kualifikimit dhe e formimit të duhur profesional të tyre<sup>13</sup>, mungesa e mjediseve të posaçme për realizimin e punës edukative në disa institucione të vëzhguara, si p.sh., në burgun e Tepelenës, të Rrogozhinës etj. Shtimi i numrit të punonjësve edukatorë do të lehtësonte shumë punën e pjesës tjetër të personelit të burgut si edhe do të ndihmonte shumë edhe vetë të dënuarit për përballimin e shqetësimeve, të problemeve dhe të nevojave të ndryshme të tyre.

Lidhur me pajisjen e burgjeve me biblioteka mund të thuhet se në të gjitha burgjet e vëzhguara kishte biblioteka, por ato kishin nevojë të pasuroheshin me libra të rinj e të kohës, pasi jo vetëm kishin një numër shumë të vogël librash, por ata ishin edhe shumë të vjetër. Të dënuarit e pyetur për këtë çështje u shprehën se kishin nevojë të lexonin libra letrarë si edhe libra ose broshura të ndryshme për t'u informuar lidhur me drejtat e tyre. Këto nevoja, sipas tyre, nuk plotësoheshin me kushtet aktuale të bibliotekave të institucioneve të vuajtjes së dënimit. Burgu i sigurisë së lartë Bënçë, p.sh., nuk dispononte asnjë dhomë të veçantë për bibliotekë.

Shembull pozitiv në këtë drejtim ishte burgu i Krujës i cili kishte tri biblioteka me një kapacitet prej 1500 librash: romane, libra fetarë dhe

---

<sup>12</sup> Kështu, p.sh., në burgun nr. 302, Tiranë, një edukator duhet të punonte mesatarisht me më shumë se 60 të dënuar njëkohësisht.

<sup>13</sup> Vetëm një pjesë e vogël e punonjësve të këtij sektori kanë formim si punonjës social ose psikolog, punonjësit e tjerë vijnë nga formime të ndryshme profesionale, si agronom, muzikant, mësues etj.

broshura informuese. Dy nga tri sallat e bibliotekës përdorëshin si mjedise edukimi dhe studimi, si dhe për takime të ndryshme dhe aktivitete të tjera argëtuese, ndërsa salla e tretë ishte kthyer në dhomë për të dënuarit për shkak të mbipopullimit të këtij institucioni.

## 2.12 Veprimtaritë kulturore, çlodhëse e sportive

Në përgjithësi, në burgje zhvilloheshin aktivitete të ndryshme kulturore, çlodhëse dhe sportive, si: lojëra argëtuese, lojëra në tavolinë (shah, tavëll), kampionate futbollit, volejbollit etj. Në burgun e sigurisë së lartë nr. 302, Tiranë, aktivitete të tilla nuk zhvilloheshin për shkak të mungesës së mjediseve të veçanta, ndaj si të vetmen mundësi argëtimi të dënuarit shihnin kohën e caktuar për ajrim. Mungesa e një fushe sportive përpara ndërtesës ku ishin vendosur të dënuarit përbënte shqetësim jo vetëm për të dënuarit, por edhe për administratën e këtij institucioni. E tillë paraqitej gjendja edhe në burgun e sigurisë së lartë në Tepelenë ku nuk kishte asnjë dhomë të veçantë për aktivitetet kulturore, përveç rasteve të veçanta kur mund të bëhej ndonjë aktivitet sportiv në mjediset jashtë rrethimit. Për ndërtimin e mjediseve të tilla dhe për të ndihmuar në organizimin e këtyre veprimtarive të cilat sanksionohen me ligj, nevojiten fonde të caktuara nga institucionet shtetërore përgjegjëse si edhe nga investimet private.

## 2.13 E drejta e besimit dhe e ushtrimit të riteve fetare

E drejta e besimit dhe e ushtrimit të riteve fetare është parashikuar në nenin 42 të ligjit<sup>14</sup>. Nga vëzhgimet rezultoi se, në

---

<sup>14</sup> Të dënuarit kanë të drejtën e besimit dhe të ushtrimit të riteve. Për ushtrimin e riteve, institucioni siguron mjedise të veçanta.

Të dënuarit kanë të drejtë të marrin kontakt me përfaqësues të komuniteteve fetare, të caktuar në marrëveshje mes Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe komuniteteve fetare të njohura ligjërisht.

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

përgjithësi, në burgje të dënuarit kishin një dhomë të veçantë kulturi për ushtrimin e riteve fetare ose kishin përshtatur një mjedis të veçantë për këtë qëllim, p.sh., në burgun e Rrogozhinës, të Peqinit, në burgun nr. 325, Tiranë, një pjesë e fjetores në seksionin e burrave ishte shndërruar në mjedis kulturi. Mjedise të tilla mungonin në burgun e Tepelenës.

Personeli i burgjeve informoi grupin e vëzhgimit të KShH-së se për festimin e festave të ndryshme fetare ftoheshin persona të jashtëm, grupe ose përfaqësues të shoqatave të ndryshme fetare (si p.sh., në burgun nr. 302, atë të Peqinit).

KShH-ja u rekomandon drejtorive të institucioneve të vuajtjes së dënimit të marrin masa për të garantuar ushtrimin e riteve fetare në këto institucione.

### 2.14 Lidhjet e të dënuarve me familjen

Në të gjitha burgjet e vëzhguara tregohet kujdes për të siguruar lidhjet e të dënuarve me familjarët e tyre. Të dënuarve u lejoheshin 4 takime në muaj. Familjarët e të dënuarve në burgun e Krujës si edhe në burgun nr. 302 Tiranë hasnin vështirësi për shkak të infrastrukturës së papërshtatshme të rrugës.

Takimet me familjarët realizoheshin në 2 ndarje të vogla, në këmbë dhe përmes hekurave, ku mund të futeshin 2 ose më shumë të dënuar njëkohësisht. Këto mjedise cenonin privatësinë e të dënuarve dhe të familjarëve të tyre. Ligji parashikon se takimet zhvillohen në vende të veçanta nën kontroll shikimi, por jo dëgjimi nga personeli mbikëqyrës<sup>15</sup>. Duke pasur parasysh këtë dispozitë ligjore, Komiteti Shqiptar i Helsinkit rekomandon krijimin e mundësive infrastrukturore në burgun nr. 302 për të realizuar takimet e të dënuarve me familjarët e tyre.

Të dënuarit e intervistuar në burgun e Bënçës, Tepelenë, shprehën shqetësimin për vështirësitë që hasnin familjarët e tyre të cilët jetonin në Veri të Shqipërisë, për të vajtur për t'i takuar në këtë institucion. Një pjesë prej tyre kërkonin transferim në ndonjë burg tjetër për të qenë më pranë familjarëve të tyre.

---

<sup>15</sup> Neni 41, paragrafi 2 i ligjit të mësipërm.

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Për gratë e dënuara problem shqetësues ishte ushtrimi i së drejtës prindërore. Për të rregulluar kujdestarinë ndaj fëmijëve të tyre ato kërkonin të ngrinin padi civile. Një pjesë dëshironin që, kur gjykatat përkatëse vendosnin kujdestarinë e fëmijve të tyre në favor të të afërmeve të tyre, të shpreheshin edhe për të drejtën e takimit të të dënuarave me fëmijët e tyre gjatë kohës kur ato vuanin dënimin.

Deri më sot praktika ka treguar se e drejta për të pasur gratë një takim special nuk respektohet duke shkelur në këtë mënyrë kërkesat e nenit 5 të ligjit për një trajtim të barabartë nga shteti.

Nga intervistat e zhvilluara me të dënuarat dhe personelin e institucionit nr. 325 rezultoi se gratë e dënuara të këtij institucioni nuk e gëzonin këtë të drejtë. Kështu, institucioni i vuajtjes së dënimit nr. 325, për gratë e dënuara nuk vepronte në përputhje me këtë nen, në të njëjtën kohë kur të drejtën për takime speciale për të dënuarit meshkuj e respektonte. Personeli i këtij institucioni e justifikoi këtë situatë me faktin se, nëse e respektonin këtë të drejtë për gratë e dënuara, kjo do të çonte në rritje të rasteve të shtatzënive dhe, në kushtet aktuale të burgjeve, përballimi i këtij problemi do të ishte i vështirë. KSHH-ja sugjeron se probleme të tilla mund të parandalohen me anë të programeve të planifikimit familjar, të ofruar nga organizatat që operojnë në këtë fushë.

Për të mbajtur lidhjet me familjarët dhe me botën jashtë institucionit të vuajtjes së dënimit, të dënuarit kanë të drejtën për të telefonuar familjen e tyre 1 herë në javë, por ka edhe përjashtime nga ky rregull, sidomos në raste urgjencash, sëmundjesh, fatkeqësish etj. Të dënuarit e intervistuar u shprehën se e drejta për të telefonuar vetëm 1 herë në javë ishte e pamjaftueshme, pasi ata merrnin në telefon familjen, fëmijët, avokatin e tyre etj. Mbipopullimi në burgje ndikonte në kohën e shkurtër që u vihej në dispozicion për bisedime telefonike të dënuarve, e cila nuk përmbushte standardet ndërkombëtare<sup>16</sup>. Në burgun nr. 302 ishte vendosur rregulli që telefonatat lejoheshin të kryheshin vetëm gjatë ditës së shtunë. Përqendrimi i gjithë telefonatave në një ditë si edhe numri i madh i të dënuarve në këtë institucion e kufizonte kohën e kryerjes së telefonatave në 5 minuta.

---

<sup>16</sup> Sipas Rregullave europiane të burgjeve, minimumi i kohës së një bisede telefonike është 10 minuta.

## 2.15 Përdorimi i dhunës

Në ligj janë parashikuar rastet e përdorimit të forcës fizike dhe të mjeteve të shtrënguese, si dhe lloji dhe natyra e tyre<sup>17</sup>. Forca fizike dhe mjetet shtrënguese nuk përdoren asnjëherë si ndëshkim ndaj të dënuarve, por vetëm në rastet që parashikohen në rregulloren e institucioneve të vuajtjes së dënimit.

Nga kontaktet që vëzhguesit e KShH-së patën me të dënuarit, por edhe me vetë personelin e burgjeve të vëzhguara në përgjithësi nuk kishin raste të keqtrajtimit ose të përdorimit të dhunës nga ana e personelit të shërbimit ndaj të dënuarve. Më shumë të dënuarit ankohe-shin për përdorim të dhunës në çastin e ndalimit ose të arrestimit të tyre nga ana e policisë ose në momentin e paraqitjes së akuzës ndaj tyre.

Megjithatë, të dënuarit e intervistuar në institucionin nr. 302, Tiranë, pretenduan se kishin pasur raste të përdorimit të dhunës fizike dhe psikologjike të ushtruar ndaj tyre nga personeli i institucionit. Ata theksuan se personeli mendonte se me sjelljen e ashpër ndaj tyre do t'i detyronin të zbatonin rregullat e institucionit. Grupi i vëzhguesve të KShH-së intervistoi edhe personelin e këtij institucioni për këtë çështje sa delikate, aq edhe të rëndësishme. Ata mohuan të kishin përdorur dhunë ndaj të dënuarve. Megjithatë, drejtuesit e institucionit pohuan një rast të vetëm të tejkalimit të përdorimit të forcës ndaj të dënuarit E. M. Ndaj punonjësit që kishte kapërcyer kompetencat që i lejonte ligji dhe rregullorja e institucionit, ishte marrë masë për paralajmërim për largim nga detyra.

## 2.16 Trajtimi i ankesave të të dënuarve

Të dënuarit kanë të drejtë të paraqesin ankesat e tyre me gojë ose me shkrim dhe në zarf të mbyllur në adresë të gjitha institucioneve të përcaktuara në nenin 49 të ligjit.

---

<sup>17</sup> Nuk lejohet përdorimi i forcës fizike ndaj të dënuarve, nëse nuk është e domosdoshme për të ndaluar aktet e dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni, si dhe për mposhtjen e kundërshtimit edhe kur ai është pasiv, në zbatimin e urdhrave të dhënë.

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Vëzhgimet treguan se një procedurë e veçantë dhe e re lidhur me ankesat e të dënuarve ishte vënë në zbatim në burgun e Peqinit. Të dënuarit ia paraqitin ankesat me shkrim edukatorit sipas seksioneve përkatëse dhe jo personelit të shërbimit, ashtu siç mund të ndodhte në institucione të tjera të vuajtjes së dënimit. Ankesat e të dënuarve shqyrtoheshin nga një komision ku rolin kryesor e luante personeli i sektorit të edukimit.

Me gjithë përvojat pozitive lidhur me funksionimin e mekanizmit të kërkesë-ankesës, KShH-ja mendon se organet përkatëse shtetërore duhet të punojnë për ta bërë këtë mekanizëm sa më funksionues dhe eficient, në mënyrë që kjo e drejtë e kërkesë-ankesës së të dënuarve të gjejë zbatim të plotë në praktikë. Për këtë duhen përmirësuar jo vetëm procedurat brenda institucionit, por duhet ngritur edhe një mekanizëm i pavarur nga institucionet e vuajtjes së dënimit në bazë, i cili duhet të mbikëqyrë si realizohet e drejta e ankesës së të dënuarve. Ky mekanizëm mbikëqyrës duhet të shqyrtojë edhe ankimmimet që mund t'u bëhen nga të dënuarit, masave disiplinore të dhëna nga drejtuesi i institucionit. Që kjo e drejtë të gjejë zbatim të plotë duhen ngritur mekanizmat përkatës dhe strukturat përgjegjëse për të pritur ankesat e të dënuarve brenda sistemit të burgjeve. KShH-ja po jep ndihmesën e vet me anë të ekspertëve të tij të huaj të cilët i kanë paraqitur Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve modele të ndryshme të vendeve të Europës Perëndimore që kanë pasur sukses me këtë mekanizëm.

### 2.17 Trajtimi i të miturve

Neni 17 i ligjit përcakton vendet e vuajtjes së dënimit për të miturit, në institucione të posaçme vetëm për ta dhe, në pamundësi, në seksione të veçanta të institucioneve të tjera sipas kriterëve të këtij ligji. Seksioni i veçantë i planifikuar për të mitur është institucioni i burgut të sigurisë së ulët në Vaqar. Në këtë institucion për të miturit kishte mjedise të veçanta, të ndara nga të rriturit. Ata qëndronin në dhoma më vete (gjithsej 3 dhoma). Të miturit e intervistuar u ankuan për faktin se ata ishin nga 7 të dënuar për dhomë. Ata dëshironin të ishin plotësisht të

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

ndarë nga të rriturit, p.sh., në një institucion më vete ose në një kat më vete për të mos pasur asnjë komunikim me të rriturit. Në këtë drejtim, KSHH-ja përsëritet përpjekjet dhe planet e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për projektin e ndërtimit të një institucioni të veçantë për të miturit, por sugjeron që ky institucion të ngrihet në një vend të përshtatshëm jo vetëm për të lehtësuar vizitat e familjarëve, por edhe për të mundësuar ofrimin e shërbimeve të ndryshme nga organizata joqeveritare.

Për të miturit e vendosur në institucionin e riedukimit në Vaqar kishte programe të veçanta, ku ishin përfshirë arsimimi, zhvillimi i kurseve të kompjuterit dhe gjuhëve të huaja (anglisht dhe italisht) si dhe aktivitete të tjera kulturore, argëtuese dhe sportive të cilat realizoheshin nga edukatorët e institucionit. Megjithatë, personeli i këtij institucioni, i pyetur për ecurinë e arsimimit të të miturve, vuri në dukje mungesat në bazën materiale dhe programet e veçanta arsimore për të miturit. Organizata të ndryshme jofitimprurëse kanë dhënë ndihmesë të çmuar me programet e tyre edukuese dhe ato të njohjes me legjislacionin e fushës, me shërbime të mirëfillta psikologjike etj., megjithatë, duhet bërë më shumë për t'i njohur të miturit me të drejtat e tyre dhe me mekanizmat e mbrojtjes së këtyre të drejtave.

Për sa u takon veshjeve dhe pajisjeve të tjera, ato, ashtu si edhe të rriturit e dënuar, të miturit i kishin siguruar nga familjarët.

Të miturit e mbanin vetë higjienën në dhomat e tyre, duke punuar me grafik. Ndryshe nga të dënuarit e rritur, ata kishin kushte dhe kujdes më të madh në këtë drejtim.

Cilësia e ushqimit për të dënuarit e mitur ishte e dobët dhe ushqimi ishte i pamjaftueshëm, ashtu si për të dënuarit e rritur. Të miturit thanë se ushqimi nuk ishte i përshtatshëm për moshën e tyre, por ishte i njëjtë me të të rriturve. Në përgjithësi, të gjithë të dënuarit e mitur merrnin ushqime nga familjet e tyre. Kjo situatë ishte në kundërshtim me kërkesat e nenit 27 të ligjit sipas të cilit të dënuarve u jepet ushqim i shëndetshëm dhe i mjaftueshëm, i përshtatshëm për moshën. Sipas po së njëjtës dispozitë, ushqimi përgatitet dhe, si rregull, jepet në mjedise të caktuara, mensa, dhe jo në dhomat e të dënuarve.

Ajrimi i të dënuarve të mitur bëhej në një seksion të veçantë. Për sa u takon veprimtarive kulturore, çlodhëse e sportive, në përputhje me

nenin 38 të ligjit, ishin zhvilluar kampionate shahu, futbolla, volejboli dhe basketbolla. Mësues fizkulture, dy herë në javë u bënë mësime dhe praktikë të miturve. Me rastin e festave të ndryshme fetare organizoheshin veprimtari fetare të tjera me ndihmën e disa organizatave jofitimprurëse dhe bashkisë së Tiranës. Brenda regjimit të burgut kishte një bibliotekë dhe një mjedis të pajisur me kompjutera për zhvillimin e kurseve të ndryshme.

Personeli i burgjeve i kushtonte kujdes zbatimit të programeve për të mitur. Por personeli i burgut i intervistuar theksoi domosdoshmërinë e shtimit të numrit të punonjësve socialë dhe të një psikologu për të punuar dhe për të trajtuar në mënyrë të veçantë të miturit.

## 2.18 Trajtimi i grave të dënuara<sup>18</sup>

Neni 17 i ligjit përcakton vendet e dënimit për gratë. Dënimi vuhet në institucione të posaçme vetëm për to dhe, në pamundësi, në seksione të veçanta të institucioneve të tjera sipas kriterëve të këtij ligji. Nënave u lejohet të mbajnë me vete fëmijën deri në moshën 3 vjeç. Për kujdesin dhe asistencën ndaj këtyre fëmijëve funksionojnë çerdhe të posaçme në institucionet e vuajtjes së dënimit.

Seksioni i veçantë i planifikuar për gratë e dënuara me vendim të formës së prerë të gjykatës ndodhet në institucionin nr. 325, Tiranë. Gratë e vendosura në këtë institucion kryesisht ishin dënuar për krime të rënda brenda familjes.

Mjediset e qëndrimit dhe të fjetjes të burgut të grave përbëheshin nga 7 dhoma. Numri i të dënuarave në dhomë shkonte deri në 8. Edhe ky seksion, ashtu si edhe seksionet e tjera në institucionet e vuajtjes së dënimit, karakterizoheshin nga mbipopullimi i dukshëm.

Veshjet dhe pajisjet edhe këtu siguroheshin nga vetë të dënuarat dhe nga familjet e tyre.

---

<sup>18</sup> Në këtë pjesë të raportit nuk do të përsëritim problemet e dala më lart lidhur me trajtimin shëndetësor të grave të dënuara, problemet lidhur me takimet speciale si edhe lidhjet e tyre me familjet dhe problematikat përkatëse.



---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Në institucionin nr. 325, për të dënuarat gra organizoheshin rregullisht veprimtari kulturore, çlodhëse e sportive si edhe veprimtari edukative mësimore. Për sa i takon arsimimit dhe edukimit të tyre, ishin ngritur kurse për mësimin e grave të paarsimuara, kurse kompjuteri, rrobaqepësie. Programi dhe realizimi i trajtimit bëhej nga administrata e burgjeve në bashkëpunim edhe me organizata jofitimprurëse. Biblioteka dhe dhomat e krijuara për ushtrimin e riteve fetare më parë kishin qenë dhoma qëndrimi për të dënuarat. Fondi i bibliotekës kishte nevojë për libra të rinj, sidomos për libra artistikë dhe shkencorë.

Një fushë volejboli dhe basketboli shërbente si mjedis i përshtatshëm për veprimtari sportive për gratë e dënuara. Nga intervistat që u zhvilluan me të dënuarat, ato ishin të kënaqura me veprimtaritë sportive që zhvilloheshin brenda institucionit.

Ritet e tyre fetare ato i ushtronin në dhoma të përshtatura, por jo në mjedise të ndërtuara për këtë qëllim. Për faltore ishte shfrytëzuar një kuzhinë e vjetër.

Kushtet higjienosanitare nuk ishin të përshtatshme. Strukturat përgjegjëse shtetërore siguronin vetëm 125 gr pluhur larës dhe 2 sapunë për çdo person për një muaj. Lavatriçet ishin të prishura, kështu gratë e dënuara nuk kishin ku t'i lanin rrobat e tyre. Ato laheshin dy herë në javë, sipas një grafiku të vendosur. Nga intervistat, të gjitha të dënuarat kishin probleme me higjienën e tyre.

Për sa i përket mjekimit, ai mbahej në infermieri në kushte të mira. Të gjitha mjekimet jepeshin me rekomandimin e mjekut. Mjekja në këtë institucion ishte patologe dhe nuk kishte asnjë mjek tjetër neurolog ose psikiatër. Kur të dënuarat gra ishin në gjendje të rëndë, ato dërgoheshin në spitalin e burgut për trajtim më të specializuar.

Administrata e institucionit nr. 325 ishte përpjekur për t'u siguruar punësim në serë për kultivimin e luleve. Gjithashtu, ato bënin edhe punime artizanale.

## 2.19 Trajtimi i të sëmurëve<sup>19</sup>

---

<sup>19</sup> Në këtë pjesë të raportit nuk do të përsëritim problematikën e sjellë më lart lidhur me trajtimin e të sëmurëve mendorë, dhe ata të paralizuar.

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Neni 16 i ligjit përcakton institucionet për të sëmurët dhe të paaftët, institutet mjekësore të posaçme, spitalet jashtë sistemit të burgjeve që shërbejnë për mjekimin e të dënuarve të sëmurë ose me shqetësime mendore e psikike. Në spitalin e burgut ishin vendosur të burgosur të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës dhe persona të paraburgosur të dërguar nga komisariatet e policisë. Kapaciteti i spitalit ishte 80 shtretër të vendosur në 4 pavijone (patologjik, infektiv, kirurgjik, psikiatrik dhe regjimi i grave).

Gjatë vëzhgimeve të KShH-së, rezultoi se kujdesi i personelit mjekësor ishte relativisht i kënaqshëm. Megjithatë, grupi i vëzhgimit konstatoi mangësi të theksuara, të cilat cenonin rëndë të drejtat e personave të sëmurë në këtë institucion.

Pajisjet (krevatë, dyshekë, çarçafë etj.) ishin tepër të vjetruara. Në disa dhoma mungonin tavolinat dhe komodinat e ushqimit. Ushqimet mbaheshin nën krevat. Dhomat ishin të ftohta dhe nuk kishin ngrohje. Kishte një banjë të përbashkët ku të sëmurët dilnin me orar.

Në datat 17-18 nëntor 2004, kur është kryer vëzhgimi, në këtë institucion ndodheshin 5 gra, njëra prej të cilave shtatzënë, 3 fëmijë dhe 13 persona të paralizuar. Fëmijët nuk kishin një mjedis të përshtatshëm për të qëndruar dhe për të kaluar kohën e lirë. Ata rrinin së bashku me nënat e tyre në po atë dhomë ku ndodhej dhe e sëmura mendore. Fëmijët nuk vaksinoheshin dhe nuk u bëheshin vizitat e duhura nga mjekët pediatër, kur dihet se fëmijët deri në moshën njëvjeçare duhet të kontrollohen një herë në javë.

Mbajtja e fëmijëve në kushte të tilla është cenim i rëndë i të drejtave të fëmijëve, të sanksionuara në konventën "Për të drejtën e fëmijëve", e cila, në nenin 3 të saj, sanksionon se në trajtimin e fëmijës duhet të mbahet parasysh interesi më i lartë i tij. Njëkohësisht janë cenuar rëndë kërkesat e nenit 17 të ligjit të mësipërm ku thuhet: "Nëna u lejohet të mbajnë me vete fëmijët deri në moshën 3 vjeç, për kujdesin dhe asistencën ndaj të cilëve funksionojnë çerdhe të posaçme".

Ushqimi ishte i njëjtë me atë të qendrës spitalore "Nënë Tereza" Një pjese të të sëmurëve ushqimin ua siguronte familja. Në spital kishte 3 fëmijë të cilët trajtoheshin njëlloj si të rriturit: një ushqim pa kaloritë e nevojshme, i ftohtë, pa asnjë vakt shtesë për fëmijët dhe nënat me gji apo

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

shtatzëna. Gjatë një misioni vlerësimi të mëvonshëm rezultoi se në këtë institucion ishin bërë përmirësime në këtë drejtim.

### 2.20 Probleme të tjera

Përveç problemeve të evidentuara në këtë raport, një nga shqetësimet e ngritura nga të dënuarit e transferuar nga burgjet greke dhe që tashmë ishin duke vuajtur dënimin në burgjet shqiptare, ishte problemi i mosnjohjes së ditëve të punës të kryera gjatë kohës që vuanin dënimin në burgjet greke. Të dënuarit ishin të ndërgjegjësuar se këto ishin probleme që lidheshin me ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të huaja dhe jo ato shqiptare.

# 3

## SUGJERIME

### Sugjerime për përmirësimin e situatës në vendet e paraburgimit

- ☞ KShH-ja tërheq vëmendjen e autoriteteve përkatëse shtetërore se zbatimi ende i rregullores së Ministrisë së Rendit, nr. 1075, datë 15.9.1999, “Për sigurimin dhe trajtimin e të paraburgosurve”, është antiligjor. Ndaj i sugjerohet Ministrisë së Drejtësisë të urdhërojë që në të gjitha vendet e paraburgimit të zbatohet rregullorja e miratuar prej saj, pavarësisht se paraburgimi në fakt nuk ka kaluar krejtësisht në varësinë e saj.
- ☞ KShH-ja vë në pah se mbajtja ende e paraburgimit në varësi të Ministrisë së Rendit përbën shkelje të rëndë të ligjit dhe kërkon nga organet kompetente të marrin masa të shpejta dhe konkrete për zbatimin e ligjit të sipërpërmendur.

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

- ☞ Duke pasur parasysh faktin se mbajtja e të dënuarve në paraburgim cenon rëndë të drejtat e kësaj kategorie shtetasish si edhe përbën shkelje të ligjit “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, KShH-ja u rekomandon organeve përgjegjëse shtetërore të marrin të gjitha masat për transferimin e të dënuarve me vendim të formës së prerë të gjykatës në vendet përkatëse të vuajtjes së dënimit.
- ☞ Bashkëpunimi mes prokurorisë së rretheve dhe DPSH-së për transferimet duhet të përmirësohet.
- ☞ KShH-ja tërheq vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse shtetërore që të përshejtojnë përpjekjet e tyre edhe në kuadër të masave të Masterplanit për sistemin e paraburgimit për të përmirësuar infrastrukturën e ndërtesave të komisariateve të policisë me qëllim përmirësimin e kushteve fizike në dhomat e paraburgimit, gjë që do të çojë në një respektim më të mirë të të drejtave të të paraburgosurve.
- ☞ KShH-ja u tërheq vëmendjen organeve përgjegjëse shtetërore se duhet të merren masat e nevojshme për të siguruar kushte të përshtatshme higjienosanitare për t’u garantuar kështu të paraburgosurve mundësi për një higjienë personale të përshtatshme. Gjithashtu, drejtuesit e institucioneve duhet të krijojnë mjedise frigoriferike për të ruajtur ushqimin e të paraburgosurve dhe këta të fundit nuk duhet të mbajnë ushqime në qeli.
- ☞ KShH-ja kërkon nga organet përgjegjëse shtetërore të respektojnë normën ushqimore dhe cilësinë e ushqimit për të paraburgosurit sipas rregullores së paraburgimit duke rritur edhe buxhetin për këtë zë. Gjithashtu, të paraburgosurit e sëmurë duhet të trajtohen me dietë të veçantë, bazuar në propozimin e mjekut.
- ☞ KShH-ja rekomandon të merren masa efikase për t’u siguruar të paraburgosurve një shërbim mjekësor në përputhje me ligjin si edhe furnizim të mjaftueshëm me ilaçe në paraburgim. Gjithashtu, duhet të krijohen mjedise të përshtatshme për të ofruar shërbimet

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

mjekësore nga mjeku ose ndihmësmjeku brenda mjediseve të paraburgimit.

- ☞ KShH-ja rekomandon që të sëmurët me probleme mendore ose psikike, të sëmurët me sëmundje kronike që mbahen në vendet e paraburgimit të transferohen në institucione të posaçme, të përcaktuara me ligj.
- ☞ Të paraburgosurit duhet të informohen për të drejtat e tyre si edhe për të drejtën për mbrojtje ligjore qysh në çastin e ndalimit dhe të arrestimit edhe në rastet kur këta të fundit nuk kanë mjetet e mjaftueshme financiare. Gjithashtu, në paraburgim të bëhet një punë më e madhe e personelit për t'i njohur të paraburgosurit me të drejtat dhe detyrimet e tyre për sa kohë janë në paraburgim. Në këtë drejtim mund të kontribuojnë edhe aktorët e shoqërisë civile.
- ☞ KShH-ja i rekomandon Ministrisë së Rendit Publik të sigurojë zbatimin e përpiktë të nenit 75 të ligjit nr. 8328 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" duke pasur parasysh këtu edhe të drejtën e personave të paraburgosur për informacion me anë të librave, revistave, gazetave etj.
- ☞ KShH-ja rekomandon marrjen e masave për zbatimin e programeve të edukimit dhe përgatitjen e personelit të specializuar në vendet e paraburgimit.
- ☞ KShH-ja i rekomandon personelit të paraburgimit të mundësojë një informim të të miturve për të drejtat dhe detyrimet e tyre.
- ☞ KShH-ja u rekomandon këtyre institucioneve të marrin masa që këta të mitur të mos mbahen në të njëjtat dhoma me persona me rrezikshmëri të lartë, duke bërë një riklasifikim të të paraburgosurve për të krijuar hapësira për një trajtim të veçantë për të miturit.
- ☞ KShH-ja rekomandon të merren masat për një trajtim të veçantë të të miturve në paraburgim dhe t'u sigurohet atyre shërbimi mjekësor dhe ai stomatologjik duke iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave të tyre.

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

- ☞ Në komisariatet e policisë të përzgjidhet personel femër për të pritur të ndaluarat dhe të arrestuarat ose të miturit në këto institucione.
- ☞ Administrata e vendeve të paraburgimit ka nevojë për trajnime të mëtejshme për t'u njohur me ndryshimet që pëson legjislacioni shqiptar penal si edhe trajnime në lidhje me zbatimin sa me korrekt të tij në praktikë duke pasur parasysh realitetin e sistemit të paraburgimit në Shqipëri.

## Sugjerime për përmirësimin e situatës në institucionet e vuajtjes së dënimit

- ☞ KShH-ja rekomandon të bëhen përpjekje për të përmirësuar infrastrukturën e ndërtesave të vjetra të burgjeve me qëllim përmirësimin e kushteve fizike në dhomat e burgjeve gjë që do të çojë në respektimin më të mirë të të drejtave të të dënuarve.
- ☞ KShH-ja u sugjeron institucioneve të vuajtjes së dënimit të marrin masa për të siguruar veshjen e të dënuarve, për të respektuar kështu dinjitetin e tyre dhe për të garantuar paraqitjen normale të tyre.
- ☞ Të merren masa për të siguruar higjienën vetjake të të dënuarve si edhe të mjedisit ku ata qëndrojnë në institucion.
- ☞ Të merren masa për rritjen e normës ushqimore për të dënuarit si edhe për rritjen e cilësisë së ushqimit që u ofrohet të dënuarve në institucionet e vuajtjes së dënimit.
- ☞ Të sigurohet shërbimi shëndetësor gjatë gjithë kohës që të dënuarit vuajnë dënimin në institucion, ndaj edhe duhet të merren masat e nevojshme në këtë drejtim. Gjithashtu, të merren masa për të siguruar shërbime të mjekëve të specializuar sidomos në institucione të vuajtjes së dënimit ku sigurohet trajtimi i veçantë për gra të dënuara, të mitur ose të dënuarit e sëmurë.

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

- ☞ KShH-ja nxit organet kompetente të marrin masa që furnizimi me ilaçe të bëhet në kohë. Gjithashtu, këto organe të marrin masa për një rritje të buxhetit për zërin “Medikamente mjekësore”, duke pasur parasysh se furnizimi i mjaftueshëm dhe në kohë me ilaçe i institucioneve të vuajtjes së dënimit është përgjegjësi e këtyre organeve shtetërore dhe detyrim ligjor.
- ☞ Të merren masa që institucionet e vuajtjes së dënimit të kenë automobulanca në rastet urgjente kur nevojitet që të dënuarit të çohen në spital.
- ☞ Të merren masat e nevojshme për të siguruar shërbim gjinekologjik në institucionin ku vuajnë dënimin gratë.
- ☞ Të sëmuretë mendorë dhe kronikë që gjenden në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe që janë dënuar me mjekim të detyruar, të transferohen në institucione të specializuara, të parashikuara në ligj.
- ☞ KShH-ja përshendet marrëveshjen ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Shëndetësisë për hapjen e institucionit të veçantë mjekësor në Durrës për trajtimin e të sëmurëve mendorë, por njëkohësisht nxit Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve që të përshpejtojnë në hapjen e këtij institucioni për të transferuar sa më shpejt të jetë e mundur të sëmuretë mendorë.
- ☞ KShH-ja i sugjeron Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të shikojë mundësinë e lirit nga vuajtja e dënimit e personave të dënuar që janë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe të pashpresë për përmirësim.
- ☞ Të zbatohet me rigorozitet ligji për informimin e të dënuarve lidhur me të drejtat e tyre me hyrjen në institucionet e vuajtjes së dënimit. KShH-ja sugjeron që ky moment paraprak dhe në vazhdim të jetë i verifikueshëm dhe i kontrollueshëm.
- ☞ Që të zbatohet një legjislacion demokratik dhe bashkëkohor, veç të tjerash, kërkohet që personat e ngarkuar me këtë detyrë të kenë koncepte të drejta, të jenë të bindur se puna e tyre duhet të



---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

kontribuojë që nesër edhe të dënuarit për krime me rrezikshmëri të theksuar shoqërore të integrohen në shoqëri. Kjo ka të bëjë me trajtimin njerëzor dhe me dinjtet e të dënuarve. KShH-ja rekomandon trajnime të mëtejshme dhe rritje kapacitetesh të administratës së burgjeve me parimet dhe standardet ndërkombëtare në trajtimin e të dënuarve.

- ☞ Pavarësisht nga fakti se në këtë raport ka pasur vetëm një rast të raportuar për përdorim të dhunës ndaj të dënuarve nga administrata në burgje, është e nevojshme që ndaj shfaqjeve të tilla të mbahen qëndrime të prera deri edhe në procedim penal të personave përgjegjës.
- ☞ KShH-ja inkurajon organet përgjegjëse të përshpejtojnë me përmirësimin e kuadrit ligjor dhe atij nënligjor në lidhje me shpërblimin e punës të të dënuarve të punësuar.
- ☞ Punësimi i të dënuarve merr rëndësi të veçantë në kuadër të edukimit dhe të riintegrit të të dënuarve në shoqëri. KShH-ja u sugjeron organeve përkatëse shtetërore të bashkërendojnë me njëra-tjetrën për të hartuar strategji për përfshirjen e sektorit privat në vënien në zbatim të projekteve për realizimin e punësimit të të dënuarve.
- ☞ Me gjithë shembujt e mirë që vijnë nga disa institucione të vuajtjes së dënimit lidhur me punën edukative në burgje, KShH-ja mendon se duhet bërë më shumë në këtë drejtim. Të merren masat e duhura për të mundësuar punën edukative me të dënuarit në burgje e cila është një detyrim ligjor që duhet përmbushur nga administrata e burgjeve.
- ☞ KShH-ja nxit organet përkatëse shtetërore të rritin fondin për libra të rinj për pasurimin e bibliotekave në burgje. Me një bashkëpunim me të mirë me sektorin e shoqërisë civile mund të rritet mbështetja që ky sektor mund të japë në këtë drejtim.
- ☞ Duke pasur parasysh faktin se veprimtaritë kulturore dhe çlodhëse kontribuojnë në rritjen e mirëqenies së të dënuarve, KShH-ja i sugjeron DPBSH-së se çdo institucion i vuajtjes së dënimit duhet të

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

mundësojë veprimtari të tilla për të dënuarit. I njëjti sugjerim vlen edhe për ushtrimin e riteve fetare për krijimin e mjediseve për të tilla aktivitete në ato institucione ku nuk ekzistojnë të tilla.

- ☞ Duke pasur parasysh se ligji i kushton rëndësi të veçantë ruajtjes, përmirësimit ose rivendosjes së lidhjeve të të dënuarve me familjarët e tyre, administrata e burgjeve duhet të krijojë mundësi që këto lidhje të jenë të vazhdueshme gjatë kohës që të dënuarit vuajnë dënimin. Gjithashtu, të dënuarit mundësisht të vendosen pranë zonës ku banojnë familjarët e tyre. Të ruhet konfidencialiteti i bisedave gjatë vizitave me familjarët.
- ☞ KShH-ja sugjeron që takimet me avokatët nuk duhen të përfshihen në numrin e takimeve të planifikuara për muaj për të dënuarit.
- ☞ KShH-ja rekomandon se të gjithë të dënuarit duhet të trajtohen në mënyrë të paanshme dhe pa asnjë lloj diskriminimi në bazë të seksit në lidhje me të drejtën e tyre për takime speciale.
- ☞ KShH-ja u sugjeron organeve përgjegjëse shtetërore të ndërhyjnë (në momentin e rregullimit të kujdestarisë së fëmijëve) me qëllim mundësimin e takimeve të të dënuarave femra me fëmijët e tyre gjatë kohës që ato vuajnë dënimin e tyre.
- ☞ Në kuadër të lidhjes me botën jashtë, KShH-ja sugjeron që të dënuarve t'u jepet mundësia e bisedave telefonike me një kohëzgjatje minimale 10 minuta për bisedë. Konfidencialiteti i këtyre bisedave telefonike duhet të ruhet në të gjitha rastet.
- ☞ KShH-ja i tërheq vëmendjen Ministrisë së Drejtësisë dhe DPBSH-së se duhen marrë masa për përmirësimin e mekanizmit të kërkesë-ankesës së të dënuarve për ta bërë atë më funksionues dhe eficient.
- ☞ KShH-ja përgëzon nismën e Ministrisë së Drejtësisë për ngritjen e një institucioni të veçantë për të miturit e dënuar, por ndërkohë duhen marrë masa të shpejta për përmirësimin e kushteve të institucionit të Vaqarit ku vuajnë dënimin të miturit për të siguruar një trajtim të veçantë për këtë kategori të dënuarish.

---

### Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

- ☞ Duhet bërë një punë më e mirë dhe e specializuar në drejtim të trajtimit psikosocial të të dënuarve të mitur dhe, në këtë drejtim, KShH-ja i sugjeron DPBSH-së të rritë numrin e specialistëve të tillë në institucionin ku vuajnë dënimin të miturit.
- ☞ KShH-ja sugjeron të përmirësohen kushtet higjienosanitare në institucionet ku vuajnë dënimin gratë me qëllim që të sigurohet higjiena vetjake dhe e mjedisit ku ato qëndrojnë.
- ☞ Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, të marrin masat e nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të kushteve në spitalin e burgut.

# 4

## SHTOJCË

**Kapaciteti dhe numri i të paraburgosurve dhe i të dënuarve  
në institucionet e paraburgimit dhe burgjet e vëzhguara nga KShH-ja  
Periudha shtator – dhjetor 2004**

<b>Dhomat e paraburgimit</b>	<b>Kapaciteti</b>	<b>Numri i të paraburgosurve</b>
Komisariati Mat	24 persona	42 persona
Komisariati Krujë	26	39
Komisariati Berat	44	61
Komisariati Lezhë	22	46
Komisariati Kukës	44	43
Komisariati Durrës	80	227
Komisariati Pogradec	18-24	32
Komisariati Tepelenë	23	18
Komisariati Elbasan	50	85
Komisariati Shkodër	50	93
Komisariati Fier	48	114
Komisariati Gjirokastër	30	38

---

Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Komisariati Korçë	50	93
Institucioni i paraburgimit 313	535	395
Institucioni i paraburgimit Vlorë	40-46	79
<b>Totali</b>	<b>1084-1096</b>	<b>1405</b>

<b>Institucionet e riedukimit</b>	<b>Kapaciteti</b>	<b>Numri i të dënuarve</b>
Burgu i Rrogozhinës	270 persona	340 persona
Burgu Tepelenë	103	83
Institucioni i veçantë Krujë	60	213
Burgu Peqin	700	650
Burgu nr. 302, Tiranë	182	200
Burgu Vaqar	147	226
Spitali i burgut	80	95
<b>Gjithsej</b>	<b>1542</b>	<b>1807</b>



***Komiteti Shqiptar i Helsinkit***  
**ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE**  
*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut*  
*Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

---

### **Gjendje e rëndë në spitalin e burgut, Tiranë**

Në kuadër të një raundi vëzhgimesh të ndërmarra nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në vendet e paraburgimit dhe në burgje, në datën 17-18 nëntor 2004 u krye një vëzhgim në spitalin e burgut, në Tiranë. Qëllimi i vëzhgimit ishte monitorimi nga afër i respektimit të të drejtave të personave të arrestuar dhe të dënuar të sëmurë.

Gjatë vëzhgimit rezultoi se kujdesi i personelit mjekësor ishte relativisht i kënaqshëm. Megjithatë grupi i vëzhgimit konstatoi mangësi të theksuara, të cilat cenojnë rëndë të drejtat e personave të sëmurë në këtë institucion.

Pajisjet (krevatë, dyshekë, çarçafë etj.) ishin tepër të vjetruara dhe të papastrat. Në disa dhoma mungonin tavolinat dhe komodinat e ushqimit. Ushqimet mbaheshin nën krevat. Dhomat ishin të ftohta dhe nuk kishin ngrohje. Kishte një banjë të përbashkët ku të sëmurët dilnin me orar.

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Në këtë institucion ndodheshin 5 gra, njëra prej të cilave shtatzënë, 3 fëmijë dhe 13 persona të paralizuar. Fëmijët nuk kishin një mjedis të përshtatshëm për të qëndruar dhe për të kaluar kohën e lirë. Ata rrinin së bashku me nënat e tyre në po atë dhomë ku ndodhej edhe e sëmura mendore. Fëmijët nuk vaksinoheshin dhe nuk u bëheshin vizitat e duhura nga mjekët pediatër, kur dihet se fëmijët deri në moshën njëvjeçare duhet të kontrollohen një herë në javë.

Mbajtja e fëmijëve në kushte të tilla është çnim i rëndë i të drejtave të fëmijëve të sanksionuara në konventën “Për të drejtat e fëmijëve” e cila, në nenin 3 të saj, sanksionon se në trajtimin e fëmijës duhet të mbahet parasysh interesi më i lartë i tij. Njëkohësisht janë cenuar rëndë kërkesat e nenit 17 të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” ku thuhet: “Nënave u lejohet të mbajnë me vete fëmijët deri në moshën 3 vjeç, për kujdesin dhe asistencën ndaj të cilëve funksionojnë çerdhe të posaçme”.

Tepër shqetësues është gjithashtu fakti se në spitalin e burgut gjenden 55 persona të sëmurë mendorë. Mbajtja e tyre në spitalin e burgut së bashku me të sëmurët e tjerë është shkelje e rëndë e nenit 82, pika 1, e dokumentit të Kombeve të Bashkuara, “Tërësia e rregullave minimum për trajtimin e të burgosurve”, i cili sanksionon se personat me të meta nuk duhet të mbyllen në burgje; duhet të merren masa për t’i transferuar ata sa më shpejt që të jetë e mundur në institucione për të sëmurët mendorë.

Vlen të përmendet se në trajtimin e të sëmurëve mendorë të deklaruar të papërgjegjshëm cenohet edhe ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, “Masat mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohen në institucionin mjekësor të specializuar...” (nenit 45) si dhe ligjit nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” ku thuhet se personat e sëmurë ose me shqetësime mendore dhe psikike vendosen në institucione mjekësore të posaçme ose seksione të veçanta në burgje ose në spitale jashtë sistemit të burgjeve që shërbejnë për mjekimin e tyre (neni 16).

---

---

## Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

Mbajtja e të sëmurëve mendorë në spitalin e burgut është cenim i rëndë edhe i nenit 46, paragrafi i tretë i Kodit penal, i cili sanksionon se masat mjekësore jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale dhe se ky vendim, në rastet e parashikuara në ligj, jo vetëm mund të revokohet, por gjykata është e detyruar ta rishqyrtojë vendimin e saj me kalimin e një viti nga dita e dhënies së tij. Drejtuesit e institucionit pretenduan se gjykata nuk ka riparë vendimet e dhëna.

KShH-ja i është drejtuar edhe më parë Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë duke kërkuar marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e kushteve në spitalin e burgut si dhe për transferimin e të sëmurëve mendorë në institucionet e specializuara, por, me gjithë premtimet e dhëna, situata vazhdon të jetë e njëjtë.

Problem tjetër shqetësues është mbajtja e 13 personave të sëmurë mendorë të paralizuar stacionarë. Ata ishin krejtësisht të paafte për t'u kujdesuar për veten dhe personeli mjekësor për trajtimin e tyre ishte i pamjaftueshëm. KShH-ja mendon se mbajtja e tyre në spitalin e burgut është e papërshtatshme. Ata kanë nevojë për trajtim të specializuar.

KShH-ja i sugjeron Ministrisë së Drejtësisë dhe Presidentit të Republikës të shikojë mundësinë e faljes së personave të dënuar në gjendje të rëndë shëndetësore dhe pa shpresë përmirësimi.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit i sugjeron Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, organeve të prokurorisë dhe të gjykatës që, në përputhje me ligjin, detyrat dhe kompetencat e tyre, të trajtojnë me seriozitet këto probleme dhe të marrin masa për zgjidhjen e tyre.

*Tiranë, më 24 nëntor 2004*



---

Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje



**Komiteti Shqiptar i Helsinkit**  
**ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE**  
*Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut*  
*Member of International Helsinki Federation for Human Rights*

---

**Tiranë, më 11 dhjetor 2004**

## **Shkelje të rënda të të drejtave të shtetasve në komisariatet e policisë së Fierit dhe të Krujës**

Gjatë periudhës 19-27 Nëntor 2004, grupe vëzhguesish të Komitetit Shqiptar të Helsinkit kryen disa vëzhgime në Komisariatet e Policisë të Fierit dhe të Krujës për të vëzhguar në vend respektimin e të drejtave të të paraburgosurve. Nga kontaktet e marra me personelin e komisariateve si dhe me personat që mbahen në vendet e paraburgimit konstatohet se:

- 1** *Mbipopullimi i vendeve të paraburgimit vazhdon të jetë shqetësues. Ndërsa kapaciteti i vendeve në komisariatet e policisë së Fierit është 48 persona, nga vëzhgimi rezultoi se në dhomat e paraburgimit ndodheshin 114 persona; kurse në komisariatet e Krujës mbahen mbi kapacitet 13 persona.*
- 2** *Si pasojë e mbipopullimit të dhomave të paraburgimit, ishin krijuar vështirësi lidhur me fjetjen dhe higjienën e personave në këto dhoma, me vendosjen e të miturve bashkë me të rriturit. Të*

---

Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

**paraburgosurit flinin në kushte të papërshtatshme, në tokë dhe në dyshekë të vjetëruar.**

- 3 *Ekziston vetëm një banjë gjë që krijon vështirësi në kryerjen e nevojave personale dhe në mbajtjen e higjenes personale dhe të ambjentit.*
- 4 *Në dy komisaritet e vëzhguara ka persona të dënuar me vendime të formës së prerë që vazhdojnë të mbahen në dhomat e paraburgimit, pavarësisht nga përpjekjet e bëra për transferimin e tyre në burgjet përkatëse.*
- 5 **Mjediset e komisaritetit të Krujës janë në një godinë e vjetër e ndërtuar që në vitin 1936; korridoret janë me lagështirë dhe të palyera.**
- 6 *Shërbimi shëndetësor është gjithashtu i pakënaqshëm. Të paraburgosurit ankohen se vizitat dhe ndihma mjekësore u jepet me vonesë.*
- 7 **Grupi i vëzhguesve mori takim me persona të paraburgosur në të dy komisaritet-objekt vëzhgimi. Pjesa më e madhe e të paraburgosurve të kontaktuar deklaruan se në kohën e ndalimit ose të arrestimit nuk vihen në dijeni për të drejtat që ata kanë sipas Kodit të Procedurës Penale.**
- 8 *Të paraburgosurit privohen nga disa të drejta që u njeh atyre ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” Në nenin 75 të këtij ligji thuhet se dispozitat e tij shtrihen edhe ndaj të paraburgosurve, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj”.*
- 9 **Për shkak të mbipopullimin të vendeve të paraburgimit, në disa raste janë kufizuar edhe takimet e të paraburgosurve në familjarët ose të afërmit e tyre, si edhe ajrosja e personave të paraburgosur në intervale dhe ambiente të caktuara.**

**Komiteti Shqiptar i Helsinkit vë në dukje se gjatë këtyre viteve ka reaguuar disa herë publikisht ndaj kësaj gjendjeje që çënon të drejtat e shtetasve**

---

---

Respektimi i të drejtave të personave në paraburgime dhe burgje

**dhe standartet minimale të përcaktuara në dokumentat ndërkombëtare dhe në legjislacionin shqiptar, por vëmë re se gjendja mbetet e njëjtë.**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është i mendimit se i takon në rradhë të parë **Ministrisë së Drejtësisë të marrë masat përkatëse për përmirësimin e kësaj gjendjeje.** Në këtë drejtim do të kontribuonte ndjeshëm, kalimi i shpejtë i vendeve të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë si dhe shfrytëzimi i të gjitha mundësive që dispozitat ligjore në fuqi të gjejnë zbatim të plotë.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit i drejtohet Ministrisë së Rendit Publik, që të marrë masat e duhura **për të zbutur problemet që ekzistojnë në vendet e paraburgimit.** Fakti që këto vende janë ende në mjediset e komisariateve dhe mbikqyren nga punonjës të policisë, **e detyron këtë Ministri të zbatojë ligjin dhe të respektojë të drejtat e personave të arrestuar. KSHH-ja rithekson faktin se personat e arrestuar deri në momentin e dhënies së një vendimi të formës së prerë nga gjykata konsiderohen të pafajshëm.**

Komiteti Shqiptar i Helsinkit **u drejtohet organeve të prokurorisë dhe të drejtësisë shqiptare që të rrisin efektivitetin dhe shpejtësinë e procedimeve penale, me qëllim që të shmangen rastet e mbajtjes së personave të arrestuar në vendet e paraburgimit deri në kufirin e afateve maksimale ligjore.**